



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 56/2020 (JR)
Datë 07.12.2020

Vendim nr. 18 (JR)
Datë 25.04.2023

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 25.04.2023, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, me sekretare gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Flutura Skënderi, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 279, datë 23.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Flutura Skënderi.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7, 8, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut; nenet 179/b dhe D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Trupi Gjykes i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Flutura Skënderi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ajo iu nënshtroi rivlerësimit *ex officio* me shortin e hedhur nga Komisioni më datë 15.11.2018.
2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshillit i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹ duke konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja i dërgoi Komisionit raportin² mbi kontrollin e figurës duke konstatuar se nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar, si dhe përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Flutura Skënderi, për vazhdimin e detyrës së gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Tiranë.

2.3. KLGj-ja ka hartuar Raportin³ për analizën e aftësive profesionale bazuar në: formularin e vetëdeklarimit dhe tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Pasi kreu hetim për të tria kriteret, në përfundim të procesit të rivlerësimit, me vendimin nr. 279, datë 23.07.2020, Komisioni vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pasi konstatoi se:

¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 15.03.2018.

² Shkresë nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 04.10.2019, të KDZh-së.

³ Shkresë nr. {***} prot., datë 20.11.2019.

3.1. *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë*, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për të kryer të gjitha investimet dhe njëkohësisht për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruar. Subjekti i rivlerësimit ka kryer disa deklarime të pamjaftueshme, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklarimit të pasurisë dhe, në këtë rast, duhet aplikuar pika 5, e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3, e nenit 61 e ligjit nr. 84/2016.

3.2. *Për kriterin e kontrollit të figurës*, subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm, sipas gurmës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

3.3. *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas gurmës “c”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016. Problematikat e konstatuara u vlerësuan të pamjaftueshme për të konsideruar subjektin nën nivelin minimal të përcaktuar nga dispozitat ligjore.

III. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Flutura Skënderi

4. Ankimi ka për objekt ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

4.1. Në shkaqet që lidhen me interpretimin e ligjit dhe të drejtat procedurale, subjekti pretendon se:

- i) është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor;
- ii) është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, duke paragjykuar haptazi vendimin;
- iii) është cenuar parimi i sigurisë juridike, parimi i barazisë para ligjit, parimi i barazisë së armëve;
- iv) janë vlerësuar provat në mënyrë të gabuar dhe haptazi të njëanshme; si dhe
- v) nuk është respektuar parimi i objektivitetit.

4.2. Arsyetimi i vendimit të Komisionit përmban shkelje të rënda procedurale dhe të ligjit material, të cilat vijnë në kundërshtim të hapur me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, sipas subjektit. Këto shkelje vërehen në mënyrën e pasqyrit të fakteve, mënyrën e arsytimit të pretendimeve të subjektit, sikurse edhe në përfundimet e arritura, të cilat janë të paarsyetuara dhe të palogjikshme, në vlerën e përcaktuar nga analiza financiare. Këto aspekte përbëjnë cenim të rëndë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

4.3. Arsyetimi i vendimit të Komisionit është i pakuptueshëm dhe subjektiv, pretendon subjekti, po ashtu. Duke referuar nenin 142 të Kushtetutës, për rëndësinë e arsytimit të vendimit të gjykatave në funksion të procesit të rregullt ligjor, subjekti pretendon se vendimi i Komisionit nuk ka arritur standardin e parashikuar sipas Kushtetutës e, për pasojë, e ka vënë të gjithë procesin e saj të rivlerësimit në dyshim. Lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, subjekti ka paraqitur raste të jurisprudencës⁴ së GjEDNJ-së, si dhe të jurisprudencës⁵ së Gjykatës Kushtetuese.

4.4. Sipas subjektit, vendimi i Komisionit nuk përmbush elementët e nevojshëm formalë dhe substancialë. Këto të meta dhe pasaktësi, sipas saj, janë të tilla që cenojnë vendimin në tërësi, e bëjnë të parregullt, duke cenuar standardin e vendimit të arsytuar.

⁴ Subjekti i rivlerësimit referon vendimet e GjEDNJ-së në çështjet *Hadjianastassiu k. Greqisë*, Aplikimi nr. 12945/87, datë 16.12.1992 dhe *Hirvisaari k. Finlandës*, Aplikimi nr. 49684/99, datë 27.09.2001.

⁵ *Shih vendimet nr. 20, datë 13.04.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese.*

4.5. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në vendim nuk pasqyrohen saktë dhe drejt provat që bindin Komisionin *tej çdo dyshimi të arsyeshëm për fshehje, mosdeklarim apo deklarim të rremë të pasurisë*. Gjithashtu, sipas subjektit, vendimi i Komisionit nuk përmban analizë financiare, ndërsa analiza e bërë në rezultatet e hetimit paraprak është tërësisht e pakuptueshme. Subjekti pretendon se megjithëse ka mbajtur qëndrim për analizën financiare, me shkrim dhe me gojë, në vendim nuk rezulton të jetë pasqyruar.

4.6. Subjekti pretendon se është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi vendosja e barrës së provës, për disa prova, që sipas ligjit të kohës kur janë kryer veprimet juridike nuk ishte e detyruar t'i prodhonte, lidhur me mundësinë ekonomike të saj dhe të bashkëshortit për të justifikuar shpenzimet e shkollimit të vajzës së saj, dokumentimi i të ardhurave nga aktiviteti sekondar i bashkëshortit, është në shkelje të këtij parimi, duke e vendosur atë në një situatë të pafavorshme ligjore.

5. Shkaqet e ankimit që lidhen me *kriterin e pasurisë* fokusohen në aspekte të konkluzionit të Komisionit që lidhen me apartamentin e banimit [me sipërfaqe 107 m², ndodhur në {***}, Tiranë] dhe të ardhurat e deklaruara të fituara nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit. Subjekti ka ngritur shkaqe ankimi edhe për konfliktin e interesit. Argumentet e parashtruara në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon.

5.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare, pasi nga sipërfaqja totale (107 m²) 57 m² janë përfituar nga shkëmbimi me truallin e përfituar me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe 50 m², sipërfaqe ndërtimore shtesë, janë blerë nga shoqëria ndërtuese [{***} ShPK] me çmimin e përcaktuar prej 40.000 eurosh. Si burim krijimi për pagesën e shumës prej 40.000 eurosh kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e banesës në bashkëpronësi me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë.

5.2. Konkluzioni i Komisionit se ajo nuk ka pasur mundësi që të përballonte me burime të ligjshme financiare shpenzimet e shkollimit të vajzës, së bashku me investimet dhe shpenzimet e tjera të kryera përgjatë viteve 2003, 2005 dhe 2006, është i pasaktë. Për të përballuar shpenzimet e studimit [në nivel *master*] të vajzës në Londër, në vitin 2004, ka marrë kredi në shumën 18.000 euro, në “Alpha Bank”, në datën 19.08.2004 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.].

5.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për mosmarrjen në konsideratë të të ardhurave të deklaruara e të përfituara të personit të lidhur/bashkëshortit nga puna dytësore me kohë të pjesshme. Të ardhurat e realizuara dhe përfituara nga bashkëshorti i saj, për periudhat 2003-2006 dhe 2008-2009, janë në shumën 1.650.000 lekë, sipas kontratave me Universitetin e Sporteve për marrjen në përdorim të palestrës së këtij universiteti për ushtrimin e aktivitetit privat. Po ashtu, për të ardhurat e personit të lidhur nga punësimi, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për mosmarrjen në konsideratë të të ardhurave nga Klubi Sportiv Tirana, të përfituara bazuar në kontratën e punësimit me orar të pjesshëm, me “Sport Klub Tirana”. Këto shuma përjashtohen nga detyrimi për derdhjen e sigurimeve shoqërore, pasi cilësohen honorare, referuar pikës 2/ë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 28.01.2015, “Për kontributet”.

5.4. Lidhur me pamjaftueshmërinë e burimeve financiare në shumën (-) 2.898.097, për vitet 2003, 2005 dhe 2006 të pasqyruara në analizën financiare të Komisionit, subjekti pretendon se ky rezultat është pasojë pasaktësisht dhe mosmarrjes në konsideratë të disa të ardhurave dhe llogaritjes gabim të disa shpenzimeve.

5.5. Mbi konstatimin e gjendjes së konfliktit të interesit, subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit mbi ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit në dy çështje gjyqësore të

gjykuara prej saj në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku palë në këtë gjykim ka qenë shoqëria {***} ShPK. Subjekti pretendon se nuk është ndjerë në asnjë moment në konflikt të interesit në pamje apo formë dhe nuk është ndikuar në asnjë rrethanë në vendimmarrjet e këtyre çështjeve.

6. Në përfundim të argumenteve, subjekti i rivlerësimit parashtron se kërkon ndryshimin e vendimit nr. 279, datë 23.07.2020, të Komisionit dhe konfirmimin e saj në detyrë. Sipas saj, vendimi objekt ankimi është i pavlefshëm, përbën shkelje të procedurës, parimeve kushtetuese të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe është tërësisht i pabazuar në ligj.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit

i) Juridiksioni i Kolegjit dhe legjitimimi i ankuesit

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, duke qenë subjekt rivlerësimi. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit⁶.

ii) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, nën dritën e parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtohet në bazë të dokumenteve. Po ashtu, në kushtet kur nga ankimi nuk rezultoi asnjë rrethanë që do të diktonte nevojën për të korrigjuar gabime procedurale apo administruar prova të reja në seancë publike në prani të subjektit të rivlerësimit⁷ edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të subjektit kundër vendimit të Komisionit, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues i Kolegjit”), në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë aspektet që shtjellohen në vijim.

8.1. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton që subjekti i rivlerësimit, më datë 01.02.2021, ka depozituar në Kolegji një *shtesë ankimi* dhe shtatë (7) akte të reja që kërkon të pranohen në cilësinë e provës. Sikurse edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni. Subjekti ka paraqitur argumente që sipas saj të çojnë në konkluzionin se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe shpenzimet e kryera. Trupi gjykues vlerësoi se shtesa e ankimit nuk përmbush kërkesat e parashikuara nga neni 63 i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon afatet dhe mënyrën e paraqitjes së ankimit në Kolegji, për rrjedhojë ky akt nuk iu nënshtrua shqyrtimit gjyqësor.

⁶ Subjektit të rivlerësimit i është njoftuar vendimi i arsyetuar më datë 19.09.2020. Ankimi i subjektit të rivlerësimit është dërguar nëpërmjet shërbimit postar, më datë 02.10.2020.

⁷ Parashikuar nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]”.

8.2. Në të njëjtën linjë, edhe aktet shkresore⁸ bashkëlidhur *shtesës së ankimit*, në kushtet që janë paraqitur jashtë afatit, nën dritën e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016⁹, kategorizohen të ndaluara nga ligji e, si të tilla, nuk u pranuan. Fakti që këto prova nuk janë paraqitur bashkë me ankimin, dhe subjekti nuk ka paraqitur ndonjë argument se nuk ka mundur t'i paraqesë këto akte në Komision, pa fajin e saj, parë edhe nën dritën e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i përjashton ato nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre, për sa i takon zgjidhjes së çështjes. Së fundmi, dhe duke abstraguuar edhe nga defekti që lidhet me mosparaqitjen në kohë të tyre si shkak të mospranueshmërisë së tyre për shqyrtim, trupi gjykues konstaton se në një vlerësim tërësor të çështjes, në raport me informacionin që përcjellin, këto akte nuk do të arrinin të ndikonin në zgjidhjen e çështjes, nën dritën e kriterëve të përcaktuara nga neni 49, pika 6, geramat “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016¹⁰.

8.3. Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë përpara seancës parashtrime dhe dy akte të reja, të cilat kërkoi të pranohen në cilësinë e provës. Ndërsa shumica e argumenteve është në të njëjtën linjë me pretendimet në ankim, në parashtrime, subjekti ka pretenduar për herë të parë ekzistencën e kursimeve të padeklaruara prej saj më parë, për periudhën shtator 2004 - janar 2005. Po ashtu, në këtë moment procedural, për herë të parë subjekti kërkoi që disa shpenzime udhëtimi të bashkëshortit [në Itali dhe ShBA] të reduktohen, pasi, sipas saj, ai ka qëndruar tek të afërm. Aktet e sjella me parashtrimet konsistojnë në një e-mail nga një e afërme e subjektit dhe një analizë financiare që pasqyron argumentet e ngritura në parashtrime. Nga kjo analizë e përcjellë prej saj, subjekti rezultoi me një mungesë burimesh relativisht të ulët. Mbi këtë bazë, subjekti në vijim kërkoi që të zbatohet parimi i proporcionalitetit e të ndryshohet vendimi i Komisionit, duke e konfirmuar në detyrë.

8.4. Në zbatim të kriterëve të përcaktuara nga neni 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, që normon provat e reja, trupi gjykues i Kolegjit nuk i pranoi as aktet e sjella nga subjekti në parashtrime, pasi i gjeti të panevojshme e të parëndësishme në zgjidhjen e çështjes¹¹.

8.5. Në vlerësim të gjithë sa shtjelluar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi që shqyrtimi i vendimit nr. 279, datë 23.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të kryhet mbi bazën e dokumenteve në dhomën e këshillimit, mbi bazën e shkaqeve të ankimit. Për këtë çështje, trupi gjykues nuk konstatoi të jenë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit.

B) Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit që lidhen me të drejtat procedurale

9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka cenuar disa nga parimet kryesore të procesit të rregullt ligjor si vijon: (i) standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor; (ii) parimi i prezumimit të pafajësisë, duke *paragjykuar* *haptazi* vendimin; (iii) parimi i sigurisë juridike; (iv) parimi i

⁸ Subjekti i ka bashkëngjitur shtesës së ankimit: (i) deklaratë noteriale, datë 02.11.2020, lëshuar nga një individ [F. M.], në të cilën deklaruesi pretendon se ka përfutur të ardhura si pedagog i Universitetit të Sporteve, nga kontrata shërbimi me kohë të pjesshme nga përdorimi i palestrës, në vitet 2001–2006; dhe tre certifikata, dy familjare dhe një martesë, lëshuar në shtator dhe tetor 2020, me anën e të cilave subjekti kërkoi të provojë lidhjen familjare midis blerësit të apartamentit të tij në datën 28.07.2006 dhe personit që i ka dhënë këstin e parë të pagesës, përkatësisht lidhjen vjehërr-dhëndër.

⁹ Kjo dispozitë parashikon: “6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji [...]”.

¹⁰ “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit. [...]”

¹¹ Parashikuar nga neni 49, pika 6, geramat “a” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016. Shih edhe poshtëshënimin më sipër.

barazisë para ligjit; (v) parimi i barazisë së armëve; (vi) provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar dhe haptazi të njëanshme; dhe (vii) nuk është respektuar parimi i objektivitetit.

9.1. Nga një analizë e pretendimeve të sipërpërmbledhura, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka identifikuar ndonjë problematikë apo rrethanë konkrete, e cila do të përbënte shkak për të mundësuar identifikimin e ndonjë prej situatave të pretenduara. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit paraqiten si një citim parimesh të procesit të rregullt, pa asnjë analizë e ilustrim konkret të veprimeve të Komisionit që kanë përbërë një ndër shkeljet e cituara në çështjen konkrete. Me fjalë të tjera, përpos renditjes së këtyre parimeve të njohura e garantuara të procesit të rregullt, subjekti nuk shpjegon sesi sjellja e Komisionit i ka cenuar ato në procesin e hetimit administrativ. Nën këtë dritë, pretendimi i shkeljes së parimeve të procesit të rregullt, meqenëse vendimmarrja ka qenë në dëm të interesave të subjektit, nuk mund të argumentohet se është element i mjaftueshëm për të legjitimuar ankimin e subjektit për këtë cenim.

9.2. Pavarësisht nga sa konstatohet më lart, trupi gjykues mori në shqyrtim të gjithë veprimtarinë procedurale të zhvilluar nga Komisioni. Nga aktet e analizuar rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur komunikim të rregullt e të shpeshtë me Komisionin gjatë gjithë fazës së hetimit administrativ. Asaj i janë drejtuar pyetje për çështje të ndryshme dhe ka kthyer përgjigje, të cilat janë vlerësuar nga Komisioni para hartimit të raportit për rezultatet paraprake të hetimit, si edhe në vendimin e marrë për këtë çështje. Gjithashtu, Komisioni i është drejtuar me pyetje subjektit edhe për çështje për të cilat ajo kishte dhënë përgjigje kontradiktore me deklaratimet e bëra në deklaratën e pasurisë *vetting* apo në deklaratat periodike vjetore (në vijim “DPV”). Marrja pjesë në mënyrë aktive përgjatë procedurës hetimore, përfshirë edhe seancën dëgjimore publike, provon edhe në nivel konkret që subjekti ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtën e saj për t’u dëgjuar e për t’u mbrojtur. Gjatë seancës publike, subjektit i është dhënë mundësia të parashtrojë prapësimet e saj, të ngrejë pretendime e të mbrohet publikisht ndaj gjetjeve të Komisionit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, për cenim të procesit të rregullt në rastin e saj, rezulton i pabazuar.

9.3. Subjekti pretendon se në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit ka konstatuar shkelje të rënda procedurale dhe të ligjit material, të cilat vijnë në kundërshtim të hapur me nenin D të Aneksit të Kushtetutës. Këto shkelje, sipas saj, vërehen në mënyrën e pasqyrimit të fakteve, mënyrën e arsyetimit të pretendimeve e deri në përfundimet e mbërritura në mënyrë të paarsyetuar dhe të palogjikshme, në vlerën e përcaktuar në analizën financiare, duke cenuar rëndë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Sipas subjektit, vendimi i Komisionit është i pakuptueshëm, subjektiv dhe nuk përmbush standardin e parashikuar nga neni 142 i Kushtetutës, për sa i përket rëndësisë që paraqet arsyetimi i vendimit të gjykatave në procesin e rregullt ligjor. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka paraqitur raste të jurisprudencës¹² së GjEDNJ-së, si dhe të jurisprudencës¹³ së Gjykatës Kushtetuese.

9.4. Sipas subjektit, të metat e pasaktësitë e vendimit të Komisionit cenojnë vendimin në tërësi, duke cenuar standardin e vendimit të arsyetuar. Konkretisht, ajo pretendon se në vendim nuk pasqyrohen saktë dhe drejt provat që bindin Komisionin *tej çdo dyshimi të arsyeshëm për fshehje, mosdeklarim apo deklarim të rremë të pasurisë*. Gjithashtu, vendimi i Komisionit nuk ka analizë financiare, ndërsa analiza e bërë në rezultatet e hetimit paraprak është tërësisht e

¹² Subjekti i rivlerësimit referon vendimet e GjEDNJ-së në çështjet *Hadjianastassiu k. Greqisë, aplikimi nr. 12945/87, datë 16.12.1992* dhe *Hirvisaari k. Finlandës, aplikimi nr. 49684/99, datë 27.09.2001*.

¹³ Subjekti i rivlerësimit referon në vendimet nr. 20, datë 13.04.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese.

pakuptueshme. Subjekti pretendon se qëndrimi i saj me shkrim dhe me gojë për analizën financiare nuk rezulton të jetë pasqyruar në vendim.

9.5. Nga analiza e akteve në fashikull dhe pretendimeve të sipërreferuara të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi i Komisionit nuk paraqet asnjë nga problemet e pretenduara nga subjekti. Parë nga ana e formës, vendimi objekt ankimi përmban bazën ligjore mbi të cilën bazohet procesi i rivlerësimit, analizën e provave të administruara, vlerësimin e Komisionit në lidhje me hetimin administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit, si dhe caktimin e masës disiplinore. Analiza financiare e pasqyruar në faqet 21 dhe 22 të rezultateve të hetimit administrativ, përcjellë subjektit, përmban të detajuar në mënyrë analitike të gjithë zërat përkatës, si dhe konkluzionin për diferencën negative që rezulton për vitet 2003, 2005 dhe 2006. Në vendimin përfundimtar, konkretisht në paragrafët 96-99, Komisioni ka përmbledhur analizën e kryer për gjithë prapësimet e bëra nga subjekti kundrejt analizës financiare të përcjellë me rezultatet e hetimit administrativ. Komisioni, po ashtu, ka identifikuar zërat specifikë që janë përlllogaritur, sipas kërkesës së saj – përfshirë pretendimin për shpenzime jetese më të ulëta për vajzën gjatë shkollimit në Britaninë e Madhe apo zbritur shpenzime të kryera për qiranë e paguar nga bashkëshorti për përdorimin e palestrës së Universitetit të Sporteve.

9.6. Vlerësimi i provave bëhet nga Komisioni në vendimin përfundimtar, pas kryerjes së hetimit administrativ dhe pas dhënies së shpjegimeve përfundimtare të subjektit në seancë dëgjimore. Po ashtu, në pjesën arsyetuese të vendimit janë pasqyruar shpjegimet e subjektit në përgjigje të pyetësorëve të zhvilluar në Komision, sikurse edhe një analizë e plotë e provave mbi bazën e të cilave është kryer vlerësimi i tri kritereve të rivlerësimit. Për secilin kriter të hetuar janë marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit dhe janë reflektuar prapësimet e saj në lidhje me disa elemente të vlerësimit të tyre. Sikurse është shtjelluar vazhdimisht nga Kolegji në jurisprudencën e tij¹⁴, fakti që Komisioni nuk i ka vlerësuar provat e sjella nga subjekti, në mënyrën e dëshiruar prej saj, nuk do të thotë se ka munguar vlerësimi lidhur me to, në kuptim të garantimit të elementeve të procesit të rregullt ligjor.

9.7. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se për nga forma dhe struktura vendimi i Komisionit është në përputhje me nenin 57 të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, edhe arsyetimi i vendimit, në kushtet që u ka dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit, dhe përmban një analizë të provave e pretendimeve, sikurse edhe peshën që kanë marrë këto pretendime në vlerësimin përfundimtar, për rrjedhojë përmban të gjitha elementet thelbësore të një vendimi, në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese¹⁵ dhe GjEDNj-së¹⁶, mbi gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve.

9.8. Subjekti pretendon se është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi barra e provës i ka kaluar për disa prova, që, sipas ligjit të kohës, kur janë kryer veprimet juridike, nuk ishte e detyruar t'i prodhonte. Të tilla janë dokumentet që provojnë të ardhurat nga aktiviteti sekondar i bashkëshortit, si dhe dokumentacioni për të justifikuar shpenzimet e shkollimit të vajzës. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në konceptin e sigurisë ligjore¹⁷, por edhe në rrethanat faktike që lidhen me subjektin e rivlerësimit.

¹⁴ Shih, ndër të tjerë, vendimin nr. 4/2021 (JR), datë 09.02.2021, të Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Eugen Beçi.

¹⁵ Shih vendimet nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 34, datë 29.05.2015; nr. 37, datë 30.06.2016, etj.

¹⁶ Shih Ruiz-Mateos kundër Spanjës, McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vermeulen kundër Belgjikës; Lobo Machado kundër Portugalisë, Kress kundër Francës, ndër të tjerë.

¹⁷ https://www.venice.coe.int/WebForms/pages/?p=02_Rule_of_law&lang=EN.

9.9. Koncepti i sigurisë ligjore, si një ndër shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës, nënkupton qasjen e lirë të qytetarëve në rregullimet ligjore, të cilat, ndër të tjera, duhet të jenë të parashikueshme dhe të kuptueshme. Nën dritën e këtij parimi, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje që subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt deklarues i pasurive dhe interesave private, që me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”). Për rrjedhojë, duke filluar nga vitet 2003-2004, ajo ka qenë e ndërgjegjësuar për detyrimet që mbante për shkak të detyrës në zbatim të këtij ligji, përfshirë edhe për të deklaruar saktësisht e me vërtetësi gjithë të ardhurat nga aktivitetet fitimprurëse ndër vite. Fryma dhe gjuha e ligjit nr. 9049/2003, përfshirë qëllimin, udhëzimet për subjektet deklarues dhe fakti që deklarimi bëhej nën përgjegjësi për vërtetësinë e sa deklarohet, përfshirë sanksionet përkatëse, por edhe procedura e kontrollit që ushtron ILDKPKI-ja, sipas neneve 25/1 dhe 27, nuk lenë vend për të argumentuar inekzistencën e ndonjë pritshmërie për të provuar të ardhurat e deklaruara me dokumentacion. Nëse do të pranohej linja e arsytimit që argumenton subjekti, ligji do të ishte i panevojshëm, pasi do të mbetej i pakuptimtë; subjektet deklarues mund të deklarorin fitime në vlera të varura nga nevoja dhe diskrecioni i deklaruesve, ndërsa qëllimi i ligjit, *përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj*, do të mbetej i paarrtshëm.

9.10. Së dyti, nga i njëjti ligj, rezulton që shpenzimet e shkollimit identifikohen në mënyrë specifike si një ndër zërat e deklarueshëm në deklaratat periodike vjetore, qoftë në mënyrë autonome, ashtu edhe si pjesë shpenzimesh që kapërcejnë vlerën 500 mijë lekë në vit, ndryshuar në 300 mijë lekë në vit, duke filluar nga viti 2014. Në të njëjtën linjë si më sipër, edhe në këtë aspekt, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit për cenim të parimit të sigurisë juridike, në kushtet kur ajo ka qenë e vetëdijshme për përgjegjësitë për të justifikuar sa deklaronte në të ardhura dhe shpenzime për secilin vit, në të cilin ka pasur shpenzime shkollimi për vajzën. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se Komisioni ka pranuar një sërë pretendimesh të subjektit për shpenzimet e shkollimit të vajzës jashtë Shqipërisë, mbi bazën e akteve të sjella prej saj, për të cilat rezulton të jetë shprehur dakord me mënyrën e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve, si dhe që hetimi ka qenë përgjithësisht objektiv dhe i paanshëm¹⁸. Në këto kushte, ky aspekt i pretendimit rezulton i pabazuar, por edhe kontradiktor me qëndrimin e mëhershëm të subjektit. Një lexim harmonik i të gjitha dispozitave ligjore në fuqi në periudhën e rivlerësimit, pretendimi i subjektit për cenim të sigurisë juridike, për shkak të kontrollit të ushtruar në procesin e rivlerësimit për pasuri e shpenzime të kryera gjatë kësaj periudhe [2003-2016], është i pabazuar.

9.11. Së fundmi, siç rezulton, ndër të tjera, edhe nga paragrafi 99 i vendimit të Komisionit, shpenzimet e shkollimit të vajzës së subjektit nuk janë i vetmi zë i analizës financiare që ka passjellë vendimin e shkarkimit. Subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare edhe për të mbuluar me burime të ligjshme kursimet në vlerën *10 mijë euro cash*, deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin në janar 2017, sikurse edhe në kushtet e deklarimeve të pamjaftueshme të konstatuara. Për këto arsye, pretendimi i subjektit se për të duhet të zbatohet parimi i proporcionalitetit paraqitet i pabazuar edhe në vlerësimin tërësor të kontrollit të kriterit të pasurisë. Me fjalë të tjera, edhe nëse abstragohet nga shpenzimet dhe investimet e kryera në periudhën kohore që përkon me vitet e shkollimit të vajzës në Britaninë e Madhe, subjekti nuk ka qenë në gjendje të krijonte kursimet e deklaruara në janar 2017, sikurse ka qenë kontradiktore për mënyrën e krijimit të apartamentit në pronësi [shtjelluar në detaj në vijim].

¹⁸ Pasqyruar në paragrafin 93 të vendimit të Komisionit.

9.12. Për sa më sipër, nuk qëndron edhe pretendimi i subjektit që shkarkimi i saj për vlerën e konstatuar të pambuluar me burime të ligjshme nga Komisioni nuk përkon me standardet e ligjit nr. 9049/2003. Sipas këtij ligji, konsiderohen parregullsi rastet kur burimet dhe pasuritë e krijuara nuk përputhen për shumën 1.000.000 lekë, për deklaratimet vjetore dhe për shumën 2.000.000 lekë për deklaratimet e bëra, sipas neneve 6 dhe 9 të këtij ligji. Trupi gjykues sjell në vëmendje se qëllimi i ligjit nr. 9049/2003 ndryshon nga ai i ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit kryhet rivlerësimi. Procesi i rivlerësimit është parë nga ligjberësi si një hap me natyrë kalimtare dhe *sui generis*, i domosdoshëm për të kthyer besimin e publikut te drejtësia. Nga ana tjetër, ligji nr. 9049/2003 dhe deklaratimet periodike, sikurse edhe kontrollat që kryhen në zbatim të tij, përbëjnë një mekanizëm standard kontrolli që përfshin subjektet deklaruese të mirëpërcaktuara dhe me natyrë jokalimtare. Pikërisht, për shkak të dallimit mes këtyre mekanizmave ligjore, baza ligjore mbi të cilën kryhet procesi i rivlerësimit është Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016.

9.13. Neni D i Aneksit të Kushtetutës parashikon se subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Procesi i rivlerësimit, në ndryshim nga mekanizmat e kontrollit të parashikuar nga ligji nr. 9049/2003, përfshin edhe kontrollin gjyqësor të vendimeve të Komisionit, nëpërmjet Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke krijuar në këtë mënyrë mekanizma të cilët garantojnë procesin e rregullt për subjektet e rivlerësimit. Këto mekanizma, sikurse edhe kuadri ligjor i rivlerësimit, kanë kaluar filtra të disafishtë të kushtetutshmërisë, sikurse vlerësimi i kryer nga Komisioni i Venecias¹⁹, nga Gjykata Kushtetuese²⁰ e së fundmi, vendimi i GjEDNj-së në çështjen kyç, *Xhoxhaj*²¹ kundër Shqipërisë. Për sa më lart, edhe ky pretendim i subjektit, që tenton të vendosë analogji mes kontrollit standard të pasurisë dhe atij kalimtar të rivlerësimit, është i pabazuar në ligj.

9.14. Së fundmi, nga analiza e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për shkelje të procesit të rregullt gjatë hetimit të kryer nga Komisioni për të, nuk rezultojnë rrethana konkrete faktike të ilustruara prej saj në këtë drejtim. Pretendimet e subjektit paraqiten si një listë parimesh të procesit të rregullt, garantuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016. Sipas këtyre dispozitave, institucionet e rivlerësimit ushtrojnë funksionet si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në analizë të akteve në fashikull, duke pasur parasysh sidomos, por jo vetëm, procesverbalin e seancës gjyqësore, pyetësorët, korrespondencën mes subjektit dhe Komisionit, nuk konstatohen veprime të Komisionit, të cilat në vetvete mund të përbënin cenim të së drejtës së subjektit për një proces gjykimi të pavarur dhe të paanshëm apo janë tejkallim i tagrave të Komisionit për vendimmarrje apo hetim. Për këto arsye, pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt nuk qëndrojnë, pasi janë të pambështetura në provat e administruara.

C) Vlerësimi i shkaqeve të ankimit

10. Ndër pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, Komisioni ka konstatuar problematika e në vijim subjekti ka ngritur shkaqe ankimi, në lidhje me: (i) apartamentin e banimit; (ii) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite; (iii) shpenzimet e shkollimit të vajzës jashtë Shqipërisë; (iv) analizën financiare; dhe (v) *cash-in* prej 10 mijë eurosh, deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin. Në vijim, shtjellohet analiza e trupit

¹⁹ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)036-e)

²⁰ Vendimi nr. 2/2017.

²¹ <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-208053>.

grykues të Kolegjit, për këto aspekte të trajtuar veçmas ose të grupuar sipas tematikës dhe shkaqeve përkatëse të ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit.

11. *Për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 107 m², në Tiranë*²²

11.1. Kjo pasuri përbëhet nga bashkimi i sipërfaqeve prej 57 m² dhe 50 m². Konkretisht, 57m² janë përfitur nga shkëmbimi me truall të përfitur me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ndërsa 50 m² sipërfaqe ndërtimore shtesë janë blerë nga një shoqëri ndërtuese [{"***"} ShPK], me çmimin e përcaktuar prej 40.000 eurosh. Komisioni ka konstatuar se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për të blerë sipërfaqen shtesë prej 50 m² dhe ka kryer deklarime të pamjaftueshme lidhur me interesat pasurore dhe transaksionet financiare. Shpjegimet e subjektit janë konstatuar jobindëse, të paprovuara dhe kontradiktore. Ndër të tjera, Komisioni ka theksuar²³ se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit ndër vite dhe përmbajtjes së deklaratës *vetting*, për sa i takon detyrimin të mbartur/mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese prej 20.000 eurosh, ka mospërputhje midis qëndrimit dhe pohimeve të administratorit të shoqërisë ndërtuese dhe shpjegimeve të subjektit të dhëna përgjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me momentin dhe mënyrën e lidhjes së marrëveshjes, zotërimin e apartamentit, kohën e kryerjes së punimeve të brendshme dhe vlerës së tyre.

11.2. Subjekti pretendon se si burim krijimi për pagesën e shumës prej 40.000 eurosh kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e një banese tjetër²⁴ në vlerën 5.000.000 lekë. Shuma prej 20.000 eurosh (pjesë e çmimit të blerjes) i është likuiduar shoqërisë [{"***"} ShPK në datën 21.11.2006 [me mandatpagesën nr. 28] dhe ka si burim pagesën e kështit të dytë të shitjes së shtëpisë, në vlerën 3.200.000 lekë. Kjo shumë, sipas subjektit, është siguruar në muajin qershor të vitit 2006. Subjekti ka pretenduar, po ashtu, se blerësit i kanë paguar që në korrik 2005, si paradhënie, vlerën prej 1.8 milionë lekësh²⁵. Me këtë shumë dhe kursime familjare, ajo ka pretenduar se është shlyer një kredi e marrë më herët në "Alpha Bank".

11.3. Pasi analizoi aktet në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara, ndërsa konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Ky vlerësim i trupit gjykues bazohet në sa rezulton nga aktet dhe analiza e tyre, siç shtjellohet në vijim.

11.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, lidhur me këtë pasuri, rezulton se subjekti ka deklaruar ndër vite, si vijon:

a. Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [deklarata *vetting*]: "[...] për sipërfaqen 120 m² është lidhur kontrata e sipërmarrjes [...] datë 16.02.2009 dhe është përfitur banesa 107 m², [...] 57 m² është përfitur nga trashëgimia dhe 50 m² është blerë sipas çmimit 800 euro/m² me vlerë 40.000 euro. Për blerjen e sipërfaqes 50 m² kemi paguar vlerën 20.000 euro, sipas mandatpagesës nr. {***}, datë 21.06.2006 [...] përfitur nga shitja e banesës në bashkëpronësi". Subjekti ka specifikuar që banesa është shitur në vlerën 5.000.000 lekë, më datë 28.07.2006 dhe ishte fituar nga ligji nr. 7652/1992, për privatizimin e banesave²⁶. Më tej, në të njëjtën deklaratë, subjekti shprehet se [...] vlera e sipërfaqes 50 m² të blerë është 40.000 euro, nga të cilat janë paguar 20.000 euro dhe pjesa e mbetur detyrim [...]. Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar edhe kontratën e kredisë me "Alpha Bank", më datë 24.03.2009, në vlerën 4 milionë lekë, për kryerjen e rifiniturave të brendshme dhe mobilimin e banesës.

²² Ndodhur në {***}.

²³ Paragrafi 43 i vendimit të Komisionit.

²⁴ Në Tiranë, në rrugën "{***}", P. {***}, Shk. {***}, Ap. {***}, në bashkëpronësi me bashkëshortin.

²⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

²⁶ "Për privatizimin e banesave shtetërore".

b. Në deklaratën periodike për vitin 2004, subjekti ka deklaruar një kredi prej 18.000 eurosh marrë nga “Alpha Bank”, në gusht të vitit në fjalë. Për sa i përket vlerës së kredisë së shlyer, subjekti ka qenë e pasaktë²⁷. Në deklaratën periodike për vitin 2005, subjekti ka deklaruar shlyerjen e plotë të vlerës së mbetur të kredisë, prej 16 mijë eurosh. Në pyetësonin nr. 2, subjekti ka pretenduar se kredia është shlyer me kursime prej 100 mijë lekësh dhe në sajë të pagesës së vlerës 1.8 milionë lekë, të përfituar përpara shitjes nga blerësit e apartamentit të përfituar nga privatizimi [shih më sipër], pasi *është rënë dakord verbalisht me blerësit që çmimi i shitjes prej 5 milionë lekësh do të paguhej me këste*. Sipas subjektit, blerësit kanë paguar 1.8 milionë lekë në fillim të muajit korrik 2005²⁸. Kontrata e shitjes së këtij apartamenti, sikurse referuar më sipër në nënpikën “a”, i përket korrikut 2006 [më 28.07.2006].

c. Në deklaratën periodike për vitin 2005, subjekti nuk ka specifikuar burimin e përdorur për shlyerjen e vlerës së mbetur të kredisë prej 16 mijë eurosh dhe as përfitimin e këstit të parë nga shitja e apartamentit, sipas marrëveshjes verbale të deklaruar në pyetësonë, e sipërcituar.

d. Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se realisht këstin e parë prej 1.8 milionë lekësh e ka fituar më 04.03.2006 – shtatë muaj pasi kishte deklaruar në përgjigje të pyetësonit nr. 2 [referuar më sipër] e, për pasojë, nuk kishte detyrim ta deklaronte këtë vlerë *cash*-i në deklaratën periodike për vitin 2005. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka sjellë dy deklarata, që mbajnë datat 04.03.2006 dhe 28.07.2006, nga dy individë²⁹. Në deklaratën e parë përshkruhet një version kronologjik pagesash, sipas kalendarit të prezantuar nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit. Deklarata e dytë, që mban të njëjtën datë me kontratën noteriale të shitjes së apartamentit, referon që apartamenti nuk është liruar në datën e shitjes e që pritet përfundimi i apartamentit të porositur tek {***} ShPK .

e. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2006, vit në të cilin daton mandatpagesa e sjellë nga subjekti me deklaratën *vetting* për të provuar shlyerjen e vlerës 20 mijë euro në favor të sipërmarrësit, subjekti nuk ka deklaruar as pagesën e 20.000 eurove dhe as detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese. Në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar vetëm shitjen e apartamentit të përfituar nga privatizimi në vlerën 5.000.000 lekë të fituar prej shitjes dhe *gjendje cash familjare* në vlerën 4.200.000 lekë.

f. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2007, dorëzuar më 31.03.2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përsëri ndryshimet e pasurive të ndodhura në vitin 2006, por jo pagesën e 20.000 eurove, sipas mandatit të referuar në deklaratën *vetting* apo detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë {***} ShPK . Nga ana tjetër, subjekti ka specifikuar në këtë deklaratë se *është realizuar kontrata e sipërmarrjes me {***} ShPK* [pa cituar ekstremitete]. Nga dokumentacioni në dosje, rezulton vetëm një kontratë sipërmarrjeje e lidhur me {***} ShPK , e cila është ajo e datës 16.02.2009. Me fjalë të tjera, ndonëse i është referuar një kontrate sipërmarrjeje që teorikisht duhet të ishte lidhur gjatë vitit 2007, meqenëse është deklaruar në deklaratën periodike të atij viti, e vetmja kontratë sipërmarrjeje e përcjellë nga subjekti e që është lidhur me këtë person juridik, daton rreth 11 muaj pas deklarimit të ekzistencës së saj për herë të parë, në mars 2008. Në rezultatet e hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar që nuk ekzistonte një kontratë sipërmarrjeje përpara asaj të shkurtit 2009, ndonëse ajo i është referuar *një marrëveshjeje/kontratë sipërmarrjeje* në deklarimet e viteve 2007, 2008 dhe 2009³⁰.

g. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar zerimin e gjendjes *cash* dhe pagesën e sipërfaqes së përfituar më tepër, sipas *kontratës së*

²⁷ Subjekti ka deklaruar se si vlera e kredisë, edhe këstet e shlyera gjatë vitit 2004, por edhe detyrimi i mbetur ishin në vlerën 18.000 euro.

²⁸ Pyetësoni nr. 2, datë 23.09.2019, pyetja nr. 4.

²⁹ Përkatësisht, z. B. E., që paraqitet në cilësinë e blerësit, dhe z. Sh. K., po ashtu, paraqitur në cilësinë e blerësit, në një distancë kohore prej katër muajsh.

³⁰ Pasqyruar në paragrafin 42 të vendimit të Komisionit, referuar verbatim faqes 9, rreshti VIII-të, të përgjigjeve me shkrim të subjektit në rezultatet e hetimit administrativ.

sipërmarrjes me shoqërinë {***} ShPK³¹, por pa specifikuar vlerën e paguar apo detyrimin e mbetur ndaj kësaj kompanie.

h. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009, subjekti ka deklaruar kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.02.2009, me shoqërinë {***} ShPK, me anë të së cilës do të përfitojë një apartament me sipërfaqe 120 m², por pa specifikuar pagesa, detyrime kundrejt shoqërisë apo shpenzime për punime të brendshme, sikurse pretendon gjatë procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar kontratën e kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.03.2009, në “Alpha Bank”, në vlerën 4.400.000 lekë.

i. Në asnjë nga dy deklaratat e fundit [2008 dhe 2009], subjekti nuk ka deklaruar shpenzimet për punime të brendshme në apartament, të kryera në vitet 2008 dhe 2009, të cilat i deklaroi në procesin e hetimit administrativ. Sipas shpjegimeve të dhëna prej saj në përgjigje të pyetësorëve, këto shpenzime shkonin përtej shumës 4.000.000 lekë, vetëm në këto dy vite³².

j. Në pyetësorë dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti e ka argumentuar mungesën e deklarimit të pagesës së 20 mijë eurove shoqërisë ndërtuese përgjatë deklaratave periodike me pretendimin se marrëdhënia me ndërtuesit nuk ishte finalizuar. Për sa i përket detyrimit të mbetur, në përgjigje të pyetësorëve, subjekti ka pretenduar të ishte kompensuar/shlyer që në vitin 2009, nëpërmjet punimeve të brendshme të kryera nga ajo vetë³³. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se kontrata e sipërmarrjes ishte kontratë tip e në të nuk parashikohej detyrimi i mbetur, por vetëm shtesa e sipërfaqes që do të përfitonte me blerjen³⁴.

k. Më datë 20.10.2017, në përgjigje me shkrim në adresë të ILDKPKI-së, administratori i shoqërisë {***} ShPK është shprehur se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e porositëses, ka kryer pagimin e vlerës prej 20.000 eurosh, sipas mandatpagesës dhe nuk ka asnjë detyrim tjetër për shkak të marrëveshjes verbale me të.

11.5. Nga analiza e akteve të mësipërme rezultojnë disa fakte të provuara, të cilat tregojnë që konkluzioni i Komisionit se subjekti ka qenë kontradiktore është i bazuar. Në këtë qëndrim, trupi gjykues mban në konsideratë disa elemente kyç të sa rezultojnë nga aktet e referuara më sipër. Së pari, rezultojnë se subjekti ka pasur një dakordësi me ndërtuesin për të blerë apartamentin që në vitin 2006. Subjekti pretendon se kjo dakordësi ishte verbale e, për pasojë, nuk kishte detyrim për të deklaruar në deklaratën periodike. I vetmi akt që ajo ka sjellë për të provuar marrëveshjen me ndërtuesin është kontrata e sipërmarrjes e vitit 2009, që përkon me një moment kohor në të cilin ajo kishte paguar të paktën 20 mijë euro dhe mbi 4 milionë lekë punime të brendshme, si dhe kishte filluar ta përdorte apartamentin. Me fjalë të tjera, subjekti

³¹ Nga dokumentacioni në dosje rezultojnë vetëm një kontratë sipërmarrjeje e lidhur me “{***}” Shpk, e cila është ajo e sipërcituara që mban datën 16.02.2009, pra, e cila nuk ka qenë në fuqi në vitin 2008.

³² Në pyetësorë, subjekti ka deklaruar se vlera e punimeve ka qenë përreth 2.6 milionë lekë, e ka paraqitur fatura punimesh, vlera e të cilave në fakt është 2.770.000 lekë, përkatësisht të shpenzuar 1.8 milionë lekë në vitin 2008 dhe 970.000 lekë në vitin 2009. Subjekti ka deklaruar edhe shpenzime për sistemin e ngrohjes dhe mobilimin në vlerën 10.500 euro për vitin 2009, që në total pasqyellin shpenzime në vlerën 2.358.000 lekë vetëm për vitin 2009 dhe për të dy vitet, 4.159.000 lekë punime të brendshme. Disa prej faturave nuk përmbajnë emrin e blerësit.

³³ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur: “[...] për shkak se punimet e brendshme të banesës nuk po kryheshin, por edhe afati i përfundimit të ndërtimit nuk po respektohej [...] është renë dakord verbalisht me shoqërinë sipërmarrëse “{***}” shpk, që punimet t’i kryenim me shpenzimet tona, [...] të cilat do të mbulonin shumën e detyrimit të pashlyer (20.000 euro). Për të përballuar punimet e brendshme dhe mobilimin e pjesshëm të banesës, në datën 23.09.2008 kemi marrë kredi bankare në “Raiffeisen Bank” në shumën 768.255 lekë, si dhe kredi bankare në “Alpha Bank” në datën 31.03.2009, në shumën 4.000.000 lekë. [...]”. Po në pyetësorin nr. 2, subjekti ka thënë: “[...] Pas përfundimit të punimeve në nëntor të vitit 2009 dhe dorëzimit të faturave për punimet e brendshme zyrës teknike të shoqërisë (sqaruar me detaje) vlera e punimeve të kryera nga ana jonë, ka përmbushur të gjithë detyrimin ndaj shoqërisë “{***}” shpk. [...], për këtë arsye, detyrimi i përfundur në vitin 2009 nuk është deklaruar në DVP-të e viteve pasuese apo deklaratën vetting”.

³⁴ Pasqyruar në paragrafin 42 të vendimit të Komisionit dhe në faqen nr. 9, rreshti VII-të i prapësimeve me shkrim, përcjellë nga subjekti për rezultatet e hetimit administrativ.

parashtron një situatë faktike në të cilën pala vulnerabël, subjekti magjistrate dhe bashkëshorti, kishin investuar një sasi të konsiderueshme likuiditetesh në një pasuri të paluajtshme, pa *asnjë* garanci ligjore dhe *asnjë* dokumentacion që të provonte këtë marrëdhënie juridike, përpos mandatpagesës së vlerës 20 mijë euro sjellë në procesin e rivlerësimit. Me fjalë të tjera, nga njëra anë subjekti përpiqet të provojë se nuk ka kryer pasaktësi në deklaratimet periodike vjetore apo *vetting*, ndërsa nga ana tjetër pranon që, ndonëse gjyqtare karriere, ajo ka derdhur një sasi monetare të ardhurash prej 20 mije eurosh dhe prej 4.1 milionë lekësh, për shkak të një dakordësie verbale me një ndërtues.

11.6. Së dyti, ndërsa në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin subjekti ka deklaruar detyrim të mbetur të *pashlyer* kundrejt sipërmarrësit, gjatë procesit të rivlerësimit, ky version faktesh u përmbys. Në procesin e hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit pretendoi që nuk kishte më *asnjë* detyrim ndaj ndërtuesit, duke e provuar me aktin shkresor, sjellë për këtë qëllim nga administratori i {***} ShPK . Përpos faktit që ky pretendim del për herë të parë gjatë hetimit administrativ, ai bie ndesh, ndër të tjera, me kontratën e sipërmarrjes mes porositësve, [subjekti dhe personi i lidhur] dhe sipërmarrësit [{***} ShPK], që mban datën 16.02.2009 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.]. Në këtë kontratë, ndonëse hartuar në një moment kohor pasi pretendohet të jenë shlyer gjithë detyrimet [dhe kryer shpenzimet për punimet e brendshme], palët nuk kanë referuar në *asnjë* segment këtë ndryshim thelbësor të kushteve kontraktuale. Pra, në hetimin administrativ, subjekti prezanton një variant faktesh që jo vetëm bie ndesh me dokumentacionin e kohës dhe me sa ka deklaruar ajo në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin dhe në deklaratat periodike vjetore, por edhe duket alogjik në kushtet kur pretendohet një dakordësi, e cila nuk ka gjetur zbatim as edhe në kontratën noteriale të sipërmarrjes, hartuar disa muaj pasi pretendohet të jetë shlyer pjesa e mbetur e detyrimit.

11.7. Këto mospërputhje e kundërtënie karakterizojnë edhe shpjegimet e tjera të subjektit për mënyrën e krijimit të pasurisë dhe shlyerjes së detyrimeve. Konkretisht, ndërsa kontrata e shitjes së apartamentit të fituar me privatizim daton *korrik 2006*, subjekti ka pretenduar se shlyerja në gusht 2005 e kredisë së marrë në “Alpha Bank” ka pasur për burim një *këst* të pagesës së kaluar asaj nga blerësit e ardhshëm të apartamentit, që në *korrik 2005*. Nga ana tjetër, deklarata noteriale për pagesën e 1.8 milionë lekëve, me një individ që paraqitet në cilësinë e blerësit të apartamentit, mban datën *mars 2006* [referuar në paragrafin 11.4, gerमत “b” dhe “d”]. Sërish, subjekti përpiqet të argumentojë që *asnjë* nga aktet noteriale të hartuara prej saj me vullnet të plotë apo deklaratat periodike të nënshkruara me përgjegjësi ndër vite³⁵, nuk pasqyrojnë realitetin, ndërsa pretendimet dhe shpjegimet e sjella prej saj në procesin e rivlerësimit janë realisht çfarë ka ndodhur.

11.8. E vetmja shkresë që referon një situatë faktike që përputhet me pretendimet e subjektit, rishtazi në procesin e rivlerësimit, është dërguar nga administratori i {***} ShPK , z. A. A.³⁶. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se sa referohet në të bie ndesh me sa palët kanë dakordësuar në kontratën e sipërmarrjes, ndër të tjerë. Përpos këtij konstatimi, rezulton që personi juridik që përfaqëson z. A. ka marrë përsipër cilësinë e dorëzanësit në kontratën e kredisë shumëqëllimore të marrë nga subjekti dhe personi i lidhur në mars 2009, nga “Alpha Bank”, për shumën 4.400.000 lekë³⁷. Nëse do të ishte e vërtetë sa pretendon subjekti për kohën kur ka shlyer detyrimet ndaj sipërmarrësit, duke abstraguuar nga pasoja e pranimit të këtij fakti kundrejt deklaratimit të saj në deklaratën *vetting*, do të ishte e pakuptimtë paraqitja e administratorit të

³⁵ Pasqyruar në detaj në nënpikat e paragrafit 11.4 që referojnë deklaratimet e subjektit ndër vite për dinamikën e krijimit të pasurisë apo pagesat e kryera.

³⁶ Referuar më sipër në paragrafin 11.4/k.

³⁷ Sipas deklaratës së supervisorit dhe menaxherit të “Alpha Bank”, më datë 27.09.2019, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Në këtë deklaratë, referohet se znj. Flutura Skënderi ka pasur një kredi në “Alpha Bank”, me limit 4.000.000 lekë. Kredia është mbyllur më datë 31.03.2019.

shoqërisë si dorëzanës, pasi subjekti kishte shlyer gjithë detyrimet. Po ashtu, është e pakuptimtë kjo situatë nëse pranohet alternativa [e deklaruar në deklaratën *vetting*], që subjekti i detyrohej ndërtuesit vlerën prej 20.000 eurosh, në kushtet kur ai nënshkroi në cilësinë e dorëzanësit, për një kredi me vlerë 4.400.000 lekë, të marrë nga subjekti për mobilimin e banesës.

11.9. Për gjithë sa argumentuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti ka qenë kontradiktore qoftë në deklaratat periodike, qoftë në funksion të procesit të rivlerësimit, për sa i përket dinamikës së pagesave të kryera për krijimin e pasurisë, kohës kur ato janë kryer, sikurse edhe të detyrimeve të shlyera përkundër atyre të mbetura pa shlyer. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me detyrimet e prapambetura të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në vlerën 20.000 euro, janë në mospërputhje me aktet në fashikull dhe me pretendimet e saj në procesin e rivlerësimit. Kjo situatë ka pamundësuar procesin e kontrollit të kriterit të pasurisë nga organet e rivlerësimit. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në kundërshtim me përcaktimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

11.10 Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë negative për vitin 2006, vit kur pretendohet se janë kryer pagesat për këtë pasuri, lexuar në harmoni me konstatimet më lart për pamjaftueshmërinë e deklarimeve të subjektit, në zbatim të detyrimeve që ajo ka si subjekt rivlerësimi, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të ngritura në këtë shkak ankimi janë jo bindëse, kontradiktore dhe të pambështetura në prova. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, në funksion të kontrollit të analizës së kryer nga Komisioni, shtjelluar në vijim në këtë arsyetim, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh të ligjshme për të kryer pagesat e deklaruara për krijimin e kësaj pasurie. Si rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

12. *Shpenzimet e shkollimit të personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit*

12.1. Ndërsa aspekte të veçanta të analizës së këtyre viteve shtjellohen edhe më sipër e në vijim, në këtë pjesë të arsytimit, trupi gjykues i Kolegjit do të ndalet në shkaqet e ankimit për këto shpenzime. Në këtë drejtim, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh në vlerën *e përgjithshme* prej rreth 1.8 milionë lekësh, për vitet 2003, 2005 dhe 2006, periudhë që përkon me shpenzimet e kryera edhe për shkollimin e vajzës së subjektit në Britaninë e Madhe dhe në Maltë.

12.2. Sipas subjektit të rivlerësimit, është i pasaktë konkluzioni i Komisionit se ajo nuk ka pasur mundësi që të përballonte me burime të ligjshme financiare shpenzimet e shkollimit të vajzës së saj, së bashku me investimet dhe shpenzimet e tjera të kryera përgjatë viteve 2003, 2005 dhe 2006. Për të përballuar shpenzimet e studimeve pasuniversitare të vajzës në Londër, subjekti ka marrë kredinë prej 18.000 eurosh, në “Alpha Bank”, më datë 19.08.2004. Kredia është mbyllur tërësisht më datë 11.08.2005, nëpërmjet pagesës së këstit paraprak në vlerën prej 1.800.000 lekësh, nga shitja e banesës së fituar me privatizim [referuar gjerësisht më sipër]. Subjekti, po ashtu, pretendon se Komisioni ka qenë i paqartë në lidhje me tri aspekte të analizës financiare e konkretisht: (i) në ç’vlerë shpenzimet e shkollimit nuk janë mbuluar me burime të ligjshme; (ii) nëse ka mangësi në deklarim apo mungesë deklarimi të saj për shpenzimet e shkollimit; dhe (iii) cilat janë shpenzimet e investimet e tjera të kryera në këtë periudhë të cilave u referohet Komisioni.

12.3. Nga aktet në fashikull, si dhe pas kontrollit të analizës financiare të kryer nga Komisioni në funksion të shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se balanca negative financiare e konstatuar në vendimin objekt ankimi konfirmohet edhe në Kolegji për vitet 2005 dhe 2006, por jo për vitin 2003. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara. Subjekti ka qenë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar kursimet dhe

shpenzimet e kryera në këto vite, përfshirë edhe shpenzimet e jetesës së vajzës, gjatë shkollimit në Britaninë e Madhe. Ndonëse qëndron pjesërisht pretendimi i subjektit për paqartësi në konkluzionet e vendimit të Komisionit, disa nga çështjet e parashtruara si të paqarta nga subjekti rezultojnë të specifikuar me shifra konkrete dhe në kushtet kur subjekti është njohur me analizën financiare të detajuar, këto përgjigje derivohen lirisht nga tabela. Arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

12.4. Vajza e subjektit ka nisur studimet pasuniversitare në Londër në vitin 2004. Nga dokumentacioni i lëshuar nga shkolla, pagesa e tarifës për këtë program studimi dyvjeçar ka qenë në vlerën 8.230 GBP ose ekuivalent me 1.470.619 lekë³⁸. Subjekti nuk e ka deklaruar këtë shpenzim në asnjë vlerë apo formë në deklaratën periodike vjetore përkatëse. Ky zë figuron në rubrikën e detyrimeve, vetëm si shpjegim për marrjen e një kredie në “Alpha Bank”. Siç referohet në mënyrë të përmbledhur më sipër [paragrafi 11.4 germa “b” dhe “d”], në deklaratën periodike për vitin 2005, subjekti ka deklaruar shlyerjen totale³⁹ të gjithë vlerës së kredisë së mbetur [16.004 euro], por jo burimet që shërbyen për të mbyllur këtë kredi. Në pyetësonin nr. 2, subjekti ka prezantuar për herë të parë *këstin* e parë të pagesës nga shitja e apartamentit të fituar nga privatizimi si burim financiar që ka mundësuar shlyerjen e kredisë [bashkë me kursimet familjare]⁴⁰. Problematika e konstatuar në lidhje me këtë pretendim është arsyetuar gjerësisht më sipër në drejtim të mospërputhjeve në kohë e në deklarime si aspekte, ndër të tjera, edhe të besueshmërisë së pretendimeve të subjektit.

12.5. Duke iu rikthyer shpenzimeve të shkollimit, ndërsa nga analiza financiare e kryer në Komision, viti 2004 rezulton me balancë pozitive, Komisioni ka përllogaritur edhe shpenzime jetese gjatë qëndrimit, në vlerën prej rreth 2.1 milionë lekësh, për periudhën 2004-2006, përpos vlerës së paguar për tarifën administrative të shkollimit. Nga analiza e kryer në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, rezulton se përllogaritja e kryer nga Komisioni është e saktë. Kredia e marrë në tetor 2004, në “Alpha Bank”, mund të ketë shërbyer për tarifën e shkollimit dhe/ose shpenzimet e jetesës, por jo për të dy këto zëra. Konkretisht, ekuivalenti i kredisë prej 18.000 eurosh, në vlerën 2.028.347 lekë, është i pamjaftueshëm për të mbuluar tarifën e shkollimit prej 1.470.619 lekësh, si dhe shpenzimet e jetesës⁴¹ në Londër, prej 2.140.540 lekësh, në një total prej 3.611.159 lekësh.

12.6. Subjekti i rivlerësimit ka kontestuar edhe përllogaritjen e kostove të jetesës së vajzës, gjatë periudhës së studimeve në Maltë dhe Mbretërinë e Bashkuar, duke pretenduar sa vijon:

- i. Referenca në dy anketat statistikore zyrtare në këto vende është e pasaktë, pasi nuk pasqyron koston minimale të jetesës të një studenti emigrant që vjen nga një vend i varfër.
- ii. Duhet marrë në konsideratë fakti se zyra e emigracionit e Mbretërisë së Bashkuar, për lëshimin e vizës së studimit ka kërkuar dokumentacion zyrtar dhe ka konsideruar si të mjaftueshme burimet financiare të paraqitura (kredia e marrë në “Alpha Bank” dhe vërtetimet e pagave të subjektit dhe bashkëshortit).
- iii. Analiza financiare e Komisionit, bazuar në të dhënat statistikore të *NSO.gov.ml*, është e gabuar.

³⁸Sipas kursit të këmbimit të botuar nga Banka e Shqipërisë për muajin përkatës në https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/

³⁹Siç rezulton nga kontrata e kredisë, në shumën 18.000 euro, datës 19.08.2004, mes kredidhënësit “Alpha Bank” dhe subjektit të rivlerësimit e personit të lidhur, me afat të pacaktuar, si dhe deklarata, datë 27.01.2020, e menaxherit dhe supervisorit të “Alpha Bank”, të cilët vërtetojnë kredinë në vlerën përkatëse, disbursuar më datë 01.10.2004 dhe mbyllur më datë 11.08.2005, në shumën 16.004 euro.

⁴⁰Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti ka thënë: “Kredia [...] disbursuar më datë. 01. 10. 2004 është mbyllur më datë. 11.08.2005 në shumën 16.004 euro. [...] Ndërsa shuma prej 16.004 eurosh për likuidimin e pjesës së mbetur të kredisë është siguruar nga kësti i parë për shitjen e banesës në bashkëpronësi”.

⁴¹Referuar faqes zyrtare të Zyrës për Statistikat Kombëtare të Britanisë së Madhe [Office for National Statistics UK, ONS].

iv. Është e pasaktë vlera e shpenzimeve të akomodimit në shumën 180 MLT në muaj, pasi qiraja është ndarë midis tre studentëve. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti sjell në vëmendje deklaratën e njëjës prej studenteve me të cilën vajza ka ndarë qiranë mujore gjatë ndjekjes së studimeve. Për rrjedhojë, zëri “akomodim” duhet të korrektohet me 2/3 e vlerës së parashikuar në përlllogaritjen statistikore të akomodimit për këtë periudhë.

12.7. Subjekti ka depozituar në Komision dy akte në mbështetje të këtyre pretendimeve: (i) një vërtetim i datës 28.03.2019, lëshuar nga universiteti ku ka studiuar vajza në Maltë, në të cilin konfirmohet periudha e studimeve në harkun kohor tetor 2000 – shtator 2004 dhe që pagesa e tarifës së studimit është përjashtuar nga Ministria e Arsimit; dhe (ii) një deklaratë para noterit publik, në Sofje, Bullgari [datë 18.05.2020], sipas të cilës deklaruesja referon ndarjen e qirasë⁴² dhe të shpenzimeve të jetesës me dy studentë të tjerë, njëra nga të cilat vajza e subjektit [znj. A. S.]. Deklaruesja shprehet⁴³ se ka ndarë apartamentin dhe shpenzimet e jetesës me znj. Skënderi edhe gjatë studimeve në Londër, në vitin 2004-2005. Deklaratës në fjalë i janë bashkëlidhur edhe kopjet e diplomave të saj nga Universiteti i Maltës dhe Universiteti në Londër.

12.8. Në mungesë të dokumentacionit provues për periudhën e studimit të vajzës së subjektit në Maltë, Komisioni është referuar në faqen zyrtare të autoritetit të statistikave të atij vendi (National Statistics Office, Malta), lidhur me shpenzimet e jetesës në harkun kohor në fjalë. Nga ky burim zyrtar rezulton se shpenzimet vjetore mesatare për vitin 2000, për një person, shkojnë në 4.821,8 MTL⁴⁴. Komisioni ka përlllogaritur vetëm gjysmën e këtij shpenzimi zyrtar vjetor, me argumentin se ishte fjala për shpenzimet e një studenteje. Konkretisht, në analizën financiare, për këtë zë shpenzimesh, Komisioni ka llogaritur 2.411,4 MTL në vit përkundër standardit zyrtar prej 4.821,8 MTL [kjo vlerë vjetore është ekuivalenti i rreth 11.000 – 12.000 eurove në varësi të kursit të këmbimit EUR/MTL për secilin vit.]

12.9. Nga verifikimet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, rezulton se faqja zyrtare e statistikave evropiane [eurostat.eu] ka të dhëna të publikuara për Maltën, duke nisur vetëm nga viti 2005, ndërsa mungojnë të dhënat për vitet 2000-2004. Vlera për shpenzimet e një personi të vetëm në nivelin e varfërisë në vitin 2005, për Maltën, përlllogaritet 6.014 euro në vit. Në analizë harmonike të këtyre të dhënave, edhe nëse pranohet që një student nuk shpenzon sa një familje mesatare prej një anëtari, gjithsesi nuk gjen zbatim nivelin e varfërisë. Për rrjedhojë, në kushtet e mungesës së dokumentacionit, përlllogaritja e kryer nga Komisioni me gjysmën e shpenzimeve vjetore të njësie familjare/ekonomike të përbërë nga një person, rezulton e drejtë, përpos tejet e favorshme. Në analizën e kryer në Kolegj u krye edhe korrektimi i periudhës kohore gjatë së cilës vajza ka qenë në Maltë gjatë vitit 2004, duke e përlllogaritur në tetë (8) muaj qëndrim, bazuar në sistemin e të dhënave elektronike të Policisë së Shtetit [TIMS]⁴⁵.

⁴²Deklaruesja, znj. L. K. B., për shpenzimet në Maltë, ndër të tjera, deklaroi se: “[...] në përpjekje për të ulur shpenzimet tona në të tria bëmë një marrëveshje për të ndarë kostot e jetesës dhe shpenzimet e akomodimit për tre vitet e para 2000-2003... shpenzimet për akomodimin dhe për koston e jetesës, të cilat shkonin 45 MTL/javë për qiranë dhe 23 MTL/javë për jetesën [...] nuk paguam për transportin dhe ishim të përjashtuara nga pagimi i taksave lokale [...]”.

⁴³ Për shpenzimet në Londër, znj. L. K. B., deklaroi se: “[...] Duke qenë se gjatë kohës që studiuam në Maltë arritëm të mbanim kostot nën kontroll në vendosëm sërish të ndanim kostot e jetesës së bashku në Londër, përkatësisht 200 GBP/javë për qiranë dhe 22.5 GBP/javë për nevoja ushqimore, ne nuk patëm kosto transporti, pasi si student ishim të përjashtuara nga detyrimi i taksave lokale [...]”.

⁴⁴ Sipas nso.gov.mt, kjo shifër përbën vlerën vjetore të shpenzimeve të konsumit për një person të pamartuar në vitin 2000.

⁴⁵ Rezulton se vajza është larguar nga Malta në fund të gushtit 2004 [në datën 27.8.2004], që nënkupton që qëndrimi nëntë muaj, sipas përlllogaritjes së kryer nga Komisioni, është i pasaktë.

12.10. Për sa i përket shpenzimeve të studimit pasuniversitar të vajzës në Londër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se kërkimi i subjektit është i pabazuar. Rezulton se Komisioni është referuar në faqen zyrtare të Zyrës Kombëtare të Statistikave në Mbretërinë e Bashkuar [ONS], nga e cila konstatohet se për periudhën 2004-2006 shpenzimet javore për person përlllogariteshin përkatësisht 182 GBP, 188 GBP dhe 192. 80 GBP. Duke konsideruar qiranë në vlerën 100 GBP/javë, bazuar në deklarinimin e subjektit dhe 80 GBP/javë për shpenzimet e tjera të jetesës, përlllogaritë: vlerën 2.912 GBP në vit, për vitin 2004; 8.272 GBP në vit, për vitin 2005; dhe vlerën 771 GBP në vit, për vitin 2006.

12.11. Nga kontrolli i analizës së Komisionit, Kolegji e gjen të drejtë referimin në faqen zyrtare të statistikave evropiane [eurostat.eu], duke marrë si standard shpenzimet e një personi të vetëm në nivelin e varfërisë për vitet 2005 dhe 2006, në Mbretërinë e Bashkuar. Në përfundim, nga dokumentacioni dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në procesin e hetimit administrativ dhe në ankim, trupi gjykues vlerëson se llogaritja e kryer nga Komisioni ka për bazë të dhënat zyrtare të publikuara për shpenzimet jetike. Për këto arsye, metodologjia e zgjedhur nga Komisioni konsiderohet e bazuar.

12.12. Më tej, vlerësohet e pabazuar kërkesa e subjektit që shpenzimet e jetesës së vajzës të përlllogariten në 1/3 e standardit gjatë periudhës së studimit në Maltë dhe 1/2 e shpenzimeve të jetesës gjatë studimeve në Londër, meqenëse shpenzimet janë ndarë me bashkëstudentet⁴⁶. Megjithëse ndarja e shpenzimeve të qirasë dhe jetesës është një praktikë e aplikuar gjerësisht nga studentët, në kushtet kur Komisioni i ka llogaritur shpenzimet e jetesës për këtë periudhë në masën 50% të shpenzimeve mesatare, reduktimi i mëtejshëm i tyre do të ishte i paargumentuar dhe i pabazuar. Së fundmi, trupi gjykues vëren se deklarata noteriale e individit në fjalë, bashkëstudente me personin e lidhur/vajzën e subjektit, rezulton e hartuar për efekt të procesit të rivlerësimit. Si e tillë, ajo ka një vlerë të kufizuar provuese për vërtetimin e shpenzimeve të reduktuara përtej standardit zyrtar e të përgjysmuar të zbatuar nga Komisioni.

13. *Të ardhurat e deklaruara nga punësimi dytësor dhe ai me orar të pjesshëm i personit të lidhur, bashkëshortit*

13.1. Pjesë e analizës së kryer nga Komisioni për deklarinimet e subjektit ndër vite, përpos sa është përmbledhur dhe shtjelluar më sipër në këtë vendim, në kuadër të shkaqeve specifike të ankimit të subjektit, janë edhe të ardhurat në shumën 1.650.000 lekë nga punësimi *dytësor* i bashkëshortit për periudhat 2003-2006 dhe 2008-2009, sikurse edhe të ardhurat nga punësimi me orar të *pjesshëm* i bashkëshortit në vitet 2015 dhe 2016, pranë Sport Klub Tirana. Për sa i përket aspektit të parë, ndonëse e ka konsideruar të provuar marrëdhënien kontraktuale të personit të lidhur, Komisioni⁴⁷ ka konstatuar që të ardhurat nuk janë provuar në terma sasiorë, si dhe nuk rezulton që të jenë paguar tatimet përkatëse. Njëkohësisht, Komisioni ka vendosur të mos përlllogarisë në ngarkim të ekonomisë familjare të subjektit shpenzimet për qiranë e ambienteve, ndonëse të provuara, meqenëse ky aktivitet duhet të ketë gjeneruar të ardhura minimalisht për balancimin e shpenzimeve të kryera. Për sa i përket të ardhurave nga punësimi me orar të *pjesshëm*, Komisioni ka konstatuar që nuk provohen pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse. Për rrjedhojë, nën dritën e parashikimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për ligjshmërinë e të ardhurave, të dy këto kategori të ardhurash nuk janë përfshirë në analizën financiare.

⁴⁶ Referuar deklaratës noteriale, datë 18.05.2020, cituar më sipër në poshtëshënimin 42 dhe 43 dhe paragrafin 12.7.

⁴⁷ Paragrafi 78, faqe 16 i vendimit të Komisionit.

13.2 Subjekti argumenton që bashkëshorti ka krijuar të ardhura nga kurse sportive duke përdorur asetet/palestrën në pronësi të Universitetit të Sporteve, bazuar në akte nënligjore⁴⁸ që mundësonin këtë aktivitet dytësor dhe ka paguar të gjitha detyrimet e përcaktuara nga Universiteti i Sporteve në kontratat midis tyre. Kështu, pagesat në shumën 1.252.000 lekë për detyrimet në periudhat 2003-2006 dhe 2008-2009, që vërtetohen me mandatpagesat përkatëse, si dhe vërtetimet e Universitetit të Sporteve, janë nga të ardhurat prej këtij aktiviteti, sipas detyrimeve kontraktuale të vendosura nga Universiteti i Sporteve. Të ardhurat e përfituara nga kjo marrëdhënie rrjedhin nga një burim i ligjshëm. Në kushtet kur Komisioni i konsideron të ligjshme pagesat, sipas detyrimeve kontraktore (pagesat për qira, drita dhe ujë), duhen të vlerësohen të ligjshme edhe të ardhurat e përfituara, të cilat janë deklaruar rregullisht në deklaratimet periodike të viteve përkatëse. Ndërsa deklaratimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore të të ardhurave nga qiraja dhe tatimi mbi të ardhurat e përfituara nga puna dytësore e bashkëshortit për periudhën në fjalë kanë qenë detyrim i Universitetit të Sporteve, mbështetur në nenin 33, pika 1, germa “d” e ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimet mbi të ardhurat”.

13.3. Për sa i përket të ardhurave nga punësimi me kohë të pjesshme, subjekti pretendon që ligjshmëria e tyre është pasojë direkt e punësimit të ligjshëm, ndërsa parashikimi kontraktor mes palëve, që detyrimet për sigurimet shoqërore do t'i shlyente punonjësi/personi i lidhur, është në kundërshtim me dispozitat tatimore, sipas të cilave përfitimet nga honorarët përjashtohen nga detyrimi për sigurimet shoqërore. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti referon nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998 dhe pikën 2.3.9 të Udhëzimit nr. 5/2006 të Ministrisë të Financave, si dhe VKM-në nr. 77/2015. Edhe nëse nuk do të konsiderohen honorarë, argumenton subjekti, neni 3 i këtij akti nënligjor parashikon kufirin maksimal të pagës si detyrim për derdhjen e sigurimeve shoqërore. Këtë detyrim, bashkëshorti e ka përmbushur me pagën e tij nga punësimi me kohë të plotë pranë Universitetit të Sporteve. Së fundmi, subjekti kërkon që përllogaritja e të ardhurave të jetë proporcionale me tatimet e papaguara, duke përfshirë si të ardhura pjesën që rezulton pas zbritjes së tatimit.

13.4. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se konkluzioni i Komisionit, për sa i përket aspektit të ligjshmërisë dhe vlerës sasiore të të ardhurave nga aktiviteti dytësor i personit të lidhur, është i bazuar. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim janë të pabazuara dhe deklarative. Nga ana tjetër, ndonëse për punësimin me kohë të pjesshme nuk janë paguar detyrimet tatimore, në kushtet kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka referuar⁴⁹ se këto detyrime i përkasin pagesit të shumës, pavarësisht nga përcaktimi kontraktual mes palëve, pretendimi i subjektit të rivlerësimit konsiderohet i bazuar. Pavarësisht nga ky fakt, duke qenë se bilanci financiar për vitet 2015 dhe 2016 është pozitiv, përfshirja e këtyre të ardhurave nuk ka asnjë efekt për zgjidhjen e çështjes në Kolegj, pasi nuk passjell ndonjë ndryshim. Në vijim shtjellohet analiza e trupit gjykues të Kolegjit mbi bazën e të cilave rezultuan këto konkluzione.

13.5. Së pari, të ardhurat nga aktiviteti *privat/dytësor*, nëpërmjet përdorimit të ambienteve të Universitetit të Sporteve, rezultojnë të jenë deklaruar në disa prej viteve të periudhës së rivlerësimit dhe rideklaruar duke i shpërndarë në çdo vit *vetëm* në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit [deklarata *vetting*]. Konkretisht, nga aktet në fashikull rezulton sa vijon:

⁴⁸ VKM-ja nr. 424, datë 09.07.1998 dhe Udhëzimi nr. 887, datë 15.03.1999, i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Mbi vënien në shërbim të të tretëve për palestrën e Atletikës, Fitnesit dhe Kondicionit fizik”, si dhe VKM-ja nr. 432, datë 28.06.2006, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”.

⁴⁹ Shkresa me nr. 8120/1 prot., datë 22.05.2020, dërguar bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, pas rezultateve të hetimit administrativ. Nga kjo shkresë rezulton përmbajtja që vijon: “[...] Klubi Sportiv Tirana, duhet të zbatojë dispozitat e nenit 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat pika 1.1 e ligjit të sipërcituar. Detyrimin për llogaritjen, mbajtjen dhe pagimin e tatimit në burim në masën 15% të shumës bruto të paguar e ka paguesi i shumës [...]”.

- a. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura në total për çdo vit në harkun kohor 2001-2009, në vlerën 2.350.000 lekë. Personi i lidhur/bashkëshorti i ka deklaruar këto të ardhura në harqe kohore, 2001-2006 dhe 2008-2009, duke *mos përfshirë* vitin 2007, ndryshe nga subjekti. Shuma, sipas personit të lidhur në deklaratën *vetting*, është po ashtu e ndryshme, 2.050.000 lekë ose 300 mijë lekë më pak sesa subjekti i rivlerësimit. Personi i lidhur/bashkëshorti ka dhënë edhe një ndarje të të ardhurave për çdo vit, që varion nga 200 mijë në 300 mijë lekë⁵⁰.
- b. Në deklaratën për vitin 2003 [deklarata e parë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9049/2003], subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në formularin A-7 marrjen me qira të palestrës së atletikës, në A.E.F.S “{***}”, sipas kontratës, datë 01.03.2003, nga bashkëshorti. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë shumë të përfituar nga kjo marrëdhënie, duke u kufizuar vetëm në paraqitjen e këtij fakti.
- c. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *shpenzimet* për marrjen e ambientit me qira (palestër) në vlerën 480.000 mijë lekë dhe ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit në vlerën 840.000 lekë.
- d. Në deklaratën periodike për vitin 2005, subjekti ka deklaruar *shpenzime* për qiranë e të njëjtit ambient, në vlerën 40.000 në muaj, ndërsa të ardhurat nga aktiviteti privat [në palestër] i ka deklaruar në shumën 1.200.000 lekë.
- e. Në deklaratat periodike për vitet 2006, 2007 dhe 2008, subjekti *nuk* ka deklaruar as *shpenzim* për qira dhe *as të ardhura* të përfituara nga ky aktivitet i ushtruar nga bashkëshorti.
- f. Në deklaratën periodike për vitin 2009, subjekti ka deklaruar të ardhur nga ushtrimi i aktivitetit në fjalë shumën prej 40.000 lekësh në muaj.

13.6. Nga analiza e dokumentacionit të sipërcituar, trupi gjykues konstaton mospërputhje të dukshme mes vlerave të deklaruara ndër vite dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Konkretisht, përpos mospërputhjes mes deklaramit të subjektit dhe personit të lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting*, si për sa përket vlerës ashtu edhe njërit prej viteve – subjekti deklaroi të ardhura për nëntë (9) vite, ndërsa bashkëshorti për tetë (8) vite – mospërputhjet hasen edhe në vlerat e secilit vit, krahasuar me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin. Asnjë prej vlerave të deklaruara ndër vite nuk përkon me sa është deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, përkundrazi. Ka vite në të cilat nuk ka asnjë deklaram në deklaratat periodike vjetore, siç janë vitet 2006-2008, ndërkohë që secili prej këtyre viteve është deklaruar me të ardhura 300 mijë lekë në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin. Po ashtu, ka vite kur subjekti deklaroi 1.2 milionë lekë në vit [viti 2005], ndërsa në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin vlera deklarohet 300 mijë lekë. Këto vlera nuk kanë ngjashmëri e as mund të konsiderohen si lapsuse referimesh në vlerë leku “të vjetër”. Një vit tjetër, ku haset diferencë serioze mes deklaratës periodike e asaj të pasurisë për rivlerësimin, është edhe viti 2004. Në këtë deklaratë, referohen të ardhurat në 840 mijë lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin deklarohen 250 mijë lekë.

13.7 Për të gjitha këto mospërputhje serioze, pretendimet e subjektit në shpjegime për gabime njerëzore janë të pakuptimta e jobindëse. Në kushtet kur vlerat nuk ngjajnë dhe inkoherenca është e përsëritur, sikurse edhe e theksuar (ka vite në të cilët në deklaratën e kohës subjekti nuk ka deklaruar asnjë të ardhur, ndryshe nga deklarata për rivlerësimin), konkluzioni i Komisionit qëndron. Subjekti nuk provoi të ardhurat në aspekt sasior, që përjashton edhe ushtrimin teorik të hetimit për ligjshmërinë e të ardhurave, sipas kriterit të përcaktuar nga neni D i Aneksit të Kushtetutës.

⁵⁰ Konkretisht, personi i lidhur ka specifikuar të ardhurat për çdo vit si vijon: “[...] për vitin 2001, 200.000 lekë (dyqind mijë lekë) të ardhura vjetore përfituar nga palestra; vitin 2002, 200.000 (dyqind mijë lekë) lekë; për vitin 2003, 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë; vitin 2004, 250.000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë; vitin 2005, 300.000 (treqind mijë) lekë; vitin 2006, 300.000 (treqind mijë) lekë; vitin 2008, 300.000 (treqind mijë) lekë; vitin 2009, 300.000 (treqind mijë) lekë [...]”.

13.8. Nga ana tjetër, Komisioni ka pranuar si të mirëqena kontratat me Universitetin e Sporteve, sjellë në Komision nga subjekti i rivlerësimit, *për marrjen në përdorim* për vitet 2001-2009, përjashtuar vitin 2007, bashkë me mandatpagesat për pagimin e qirasë së ambientit, sikurse edhe një *vërtetim*⁵¹ i hartuar gjatë hetimit administrativ. Në këto kushte, pavarësisht nga mungesa e arsytimit të Komisionit në drejtim të sa do të rezultonte nga një analizë krahasimore rigoroze mes kontradiktave të thella për të ardhurat deklaruar ndërsa vite, si dhe problemit të ligjshmërisë së tyre apo ekzistencës në vlera sasiore, kundrejt momentit kur subjekti ka sjellë për herë të parë akte ligjore mbështetëse, trupi gjykues i Kolegjit, nën dritën e kufizimeve procedurale në ankim, i konsideroi këto akte pa ndikim në zgjidhjen e çështjes dhe nuk ngarkoi subjektin me shpenzime për qiratë.

13.9. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se marrja me qira e ambientit nuk nënkupton domosdoshmërisht një fitim të paktën të barabartë me shpenzimin. Arsyetimi i Komisionit është i pabazuar në logjikën e thjeshtë, edhe nëse mbahet në konsideratë kohëzgjatja e marrëdhënies së qirasë. Pagesa e qirasë nuk nënkupton domosdoshmërisht siguri për fitim të kthyer. Me fjalë të tjera, fakti që bashkëshorti i subjektit ka paguar qira për disa orë në javë për disa vite nuk përbën gjurmë të ardhurash në kuptim të ligjit, as për ekzistencë të ardhurash në vlerë të arsyeshme e, natyrisht, nuk nënkupton vlerë të barabartë me shpenzimin e qirasë apo ligjshmërinë e fitimeve, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Pagesa e shpenzimeve të qirasë në vetvete përbën thjesht konfirmim të një shpenzimi të kryer. Këtë shpenzim të kryer, Komisioni nuk e ka përlogaritur në analizën financiare. Në këtë mënyrë, Komisioni ka favorizuar në mënyrë të konsiderueshme subjektin në analizën financiare të viteve përkatëse nga mospërfshirja e një shpenzimi të deklaruar, të pranuar dhe të pakontestuar, ekzistenca e të cilit, ndryshe nga fitimi, paraqitet *e sigurt*.

13.10. Grupi tjetër i të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit të subjektit, që janë pjesë e shkaqeve të ankimit, janë ato nga punësimi me kohë të *pjesëshme* për vitet 2015 dhe 2016. Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare të viteve përkatëse këto të ardhura, pasi nuk ka rezultuar pagesa e detyrimeve tatimore. Pa ripërsëritur sa është shtjelluar më sipër, trupi gjykues thekson së pari që ky qëndrim i Komisionit nuk ka ndikimin në zgjidhjen e çështjes, duke pasur në konsideratë arsyetimin në vijim për *cash-in* e deklaruar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin. Së dyti, në funksion të shterimit të analizës së vendimit objekt ankimi dhe për krijimin e një panorame qartësuese të besueshmërisë së subjektit në vlerësimin e pasurisë, sipas testit të përcaktuar në nenin 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues e sheh të nevojshme t’i shtjellojë në mënyrë të përmbledhur aspektet që vijnë.

13.11. Nga aktet në fashikull, për të ardhurat nga punësimi i bashkëshortit më orar të pjesëshëm në 2015 dhe 2016, rezultojnë deklaratimet e mëposhtme:

a. Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [*vetting*], subjekti ka deklaruar të ardhura nga ky angazhim për dy muaj në vitin 2015, në vlerën në total prej 70.000 lekësh [35.000 lekë në muaj], ndonëse në narrativë përfshin tre muaj. Personi i lidhur/bashkëshorti deklaron të ardhura në vlerën 70.000 lekë, por vetëm për punësim gjatë muajit tetor. Për vitin 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura për gjithë vitin në vlerën 350.000 lekë, nga 35.000 lekë në muaj⁵². Personi i lidhur/bashkëshorti nuk ka deklaruar të ardhura për vitin 2016.

b. Në deklaratën periodike për vitin 2015, subjekti ka deklaruar të ardhura për katër (4) muaj në vitin 2015, referuar kontratës së punësimit *në vlerën 35.000 lekë*. Në të njëjtën deklaratë, kontrata e referuar në fakt përfshin vetëm pesë (5) muaj të vitit 2016. Në deklaratën periodike për vitin 2016, subjekti ka referuar 12 muaj punësim *me pagë 350.000 lekë*.

⁵¹ Shkresë që mban datën 25.09.2019 [nr. {***}], e administratorit të Universitetit të Sporteve, sipas të cilës konfirmohen pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe kontratat e sjella prej saj në hetimin administrativ.

⁵² Shuma aritmetike e vlerës në fakt do duhet të ishte 420.000 lekë ose 35.000 lekë x 12 muaj.

c. Në pyetësorë gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se detyrimet tatimore për këto të ardhura janë përgjegjësi e institucionit [Klubi Sportiv Tirana].

d. Në dy kontrata punësimi të personit të lidhur me Klubin Sportiv Tirana, njëra përfshin vetëm tre muajt e fundit të vitit 2015, ndërsa tjetra [me nr. {***}] përfshin nëntë (9) muaj, duke filluar nga 01.09.2015 deri në 31.05.2016. Në të dy kontratat paga referohet *bruto* 35.000 lekë në muaj, ndërsa sigurimet janë në *ngarkim* të vetë punonjësit. Në fashikull ndodhet edhe një vërtetim page i vitit 2016 që referon kontratën nr. {***} dhe pagën *bruto* 35.000 lekë në muaj.

e. Në të njëjtën periudhë kohore, nga aktet rezulton që bashkëshorti i subjektit ka qenë i punësuar pranë Universitetit të Sporteve dhe janë mbajtur dhe paguar detyrimet tatimore⁵³ që rrjedhin nga paga maksimale si pedagog pranë këtij Universiteti.

f. Nga shkresa e dërguar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore [datë 29.07.2019], konfirmohet se *nuk* janë paguar sigurimet shoqërore për të ardhurat nga puna e bashkëshortit.

g. Në maj 2020, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, subjekti ka përcjellë në Komision një shkresë dërguar bashkëshortit në përgjigje të kërkesës së këtij të fundit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Sipas kësaj shkrese, punëdhënësi duhet të mbante tatimin në burim në masën 15% të pagës *bruto*⁵⁴.

13.12. Nga sa më sipër, konstatohen mospërputhje substanciale, si mes deklarimeve të subjektit e personit të lidhur, ashtu edhe kundrejt kontratës së punësimit nr. {***}, për sa i përket datës së fillimit të efekteve të marrëveshjes. Konkretisht, në deklaratën *vetting* deklarohet tetori 2015 si fillim punësimi, ndërsa në kontratë referohet muaji shtator 2015. Mospërputhje ka edhe mes dy kontratave të punësimit, sikurse edhe në deklarin e të ardhurave. Konkretisht, njëra prej kontratave përfshin kohën e punësimit të parashikuar tek tjetra duke u mbivendosur për tre muaj [tetor-dhjetor 2015]. Po ashtu, përpos gabimit aritmetik të përlllogaritjes së të ardhurave të vitit 2016, rezulton që subjekti ka përlllogaritur si të ardhur familjare ato *bruto*, prej 35.000 lekësh, pavarësisht pretendimit të mëvonshëm se honorarët nuk taten apo që kontrata që parashikon detyrimet fiskale në ngarkim të bashkëshortit bie ndesh me ligjin. Deklarimet e subjektit në deklaratën *vetting*, sikurse edhe në deklaratat periodike vjetore për pagën *bruto*, tregojnë që mbajtja e të ardhurave në burim nuk ka qenë në fokus.

13.13. Pavarësisht nga kjo analizë, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur këto vite, 2015 dhe 2016, siç referohet gjerësisht më sipër, nuk kanë ndikim në analizën financiare, pasi janë me balancë pozitive, trupi gjykues e konsideron të ezauruar këtë shkak ankimi.

14. Pamjaftueshmëria e burimeve financiare dhe analiza financiare

14.1 Sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni, subjekti gjendet në situatën e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare në shumën (-) 2.898.097 për vitet 2003, 2005 dhe 2006. Komisioni⁵⁵ ka arsyetuar, ndër të tjera, se edhe duke e marrë në versionin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me shpenzimet e reduktuara për studimet jashtë shtetit të vajzës dhe zbritur nga shpenzimet, *pagesat e qirasë* për aktivitetin privat të bashkëshortit [arsyetuar gjerësisht më sipër], rezulton një bilanc i përgjithshëm negativ, me një total prej (-) 1.800.083 lekësh, mungesë financiare e përqendruar në vitet 2005 dhe 2006. Përpos kësaj vlere, Komisioni thekson problematikën e konstatuar për pamundësinë e *gjendjes cash* prej 10 mijë eurosh, jashtë sistemit bankar, të deklaruar në deklaratën *vetting*. Bashkërisht me deklarin e pamjaftueshme të pasurive nga problemet e konstatuara, Komisioni konkludoi se subjekti ka

⁵³ Vërtetimi nr. {***}, datë 30.04.2020, i Universitetit të Sporteve sipas të cilit : “[...] Prof. Dr. Dh. S. punon si staf akademik në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, pranë Universitetit të Sporteve Tiranë [...]” dhe të ardhurat personale bruto dhe neto për periudhat 2003-2007 referohen të detajuara në tabelë.

⁵⁴ Shkresë me nr. {***} prot., datë 22.05.2020. Referuar edhe në poshtëshënimin nr. 49.

⁵⁵ Paragrafi 98, faqja 21 e vendimit të Komisionit.

pasur mungesë burimesh financiare të mjaftueshme për të kryer investimet dhe përballuar shpenzimet.

14.2 Përpos shkaqeve të ankimit për zëra të caktuar të analizës financiare që janë shtjelluar gjerësisht më sipër⁵⁶, subjekti kërkon edhe korrigjimin e analizës financiare për secilin vit të konstatuar me balancë negative, duke parashtruar që:

(i) për vitin 2003, pasuritë e deklaruara në deklaratën e parë (automjet dhe apartament) nuk i përkasin analizës financiare të atij viti. Këto pasuri janë përfituar me të ardhura të krijuara përpara deklaratimit të vitit 2003. Po ashtu, subjekti kërkon që në të ardhurat e bashkëshortit për atë vit të shtohen 6.905 lekë;

(ii) për vitin 2004, të shtohen 30.165 lekë të ardhura të bashkëshortit, ndërsa kredia e marrë të konsiderohet e përdorur për shpenzimet e jetesës së vajzës në Britaninë e Madhe atë vit dhe vitin në vijim;

(iii) shpenzimet e qëndrimit e shkollimit të vajzës në Maltë në vitet 2000-2004 të zbriten në 2/3 e vlerës;

(iv) analiza financiare e vitit 2005 të përfshijë të ardhurat nga punësimi i vajzës për disa muaj pranë River Island, në vlerën 400 GBP. Po ashtu, subjekti pretendon se shpenzimet e jetesës së vajzës studente në Maltë e Britaninë e Madhe duhet të jenë më të ulëta sesa ato të statistikave zyrtare në këto vende;

(v) të korrigjohen të ardhurat e vajzës për vitin 2006 në 562.032 lekë dhe jo 224.813 lekë dhe të korrigjohet analiza financiare për vitin 2006, për shkak se kredia e marrë është 500.000 lekë dhe jo 408.000 lekë. Së fundmi, për vitin 2006, shpenzimet e udhëtimit të vajzës në vlerën 1.050 euro, janë mbuluar nga punëdhënësi.

14.3. Nga ana tjetër, subjekti nuk rezulton të ketë trajtuar në mënyrë të veçantë problematikën e konstatuar nga Komisioni në lidhje me pamundësinë e krijimit të kursimeve *cash*, të deklaruara në deklaratën *vetting*. Meqenëse subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni në tërësi, në arsyetimin në vijim përfshihet edhe analiza e këtij aspekti të kontrollit të pasurisë së deklaruara në deklaratën *vetting*.

14.4. Pasi analizoi këto shkaqe ankimi, në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se balanca negative financiare pëson një ulje për shkak të korrigjimeve të kryera në analizën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, për vitin 2003. Pavarësisht nga këto korrigjime, balanca negative e përfutur mbetet në nivel të tillë që nuk ndryshon zgjidhjen përfundimtare. Subjekti rezulton në një balancë negative minimalisht prej (-) **2.016.945 lekësh**, *vetëm* për vitet 2005 dhe 2006, sikurse edhe *në pamundësi* për të krijuar 10.000 euro *cash* kursime të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Ky vlerësim mban në konsideratë edhe parimin procedural të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit në ankim, duke pranuar përlllogaritjen e Komisionit, pavarësisht se në të [në analizë] nuk përfshihen shpenzime të deklaruara ndër vite në mënyrë të shprehur për aktivitetin dytësor të bashkëshortit⁵⁷, siç ishte shpenzimi i qirasë së ambientit palestër. Në vijim, arsyetimi ndalet në pretendimet e subjektit për secilin vit, përveç shkaqeve të ankimit që ndonëse lidhen me analizën financiare janë shqyrtuar gjerësisht më sipër.

⁵⁶ Konkretisht, shkaqet e ankimit të cilat janë shtjelluar veçmas e gjerësisht më sipër lidhur me: të ardhurat e gjeneruara nga punësimi dytësor i bashkëshortit, pagesa e "këstit" prej 1.8 milionë lekësh në 2005 nga shitja në vitin 2006 e apartamentit të përfituar nga privatizimi, në funksion të mbulimit të shpenzimeve për shlyerjen e kredisë në "Alpha Bank", që në gusht 2005 dhe pagesën e shkollimit pasuniversitar të vajzës në Britaninë e Madhe në vitet 2004-2005.

⁵⁷ Shih më sipër deklaratat periodike vjetore të subjektit në paragrafin 13.6/c, d dhe f. Në disa prej viteve, e konkretisht 2004, 2005 dhe 2009, subjekti ka detajuar në mënyrë specifike shpenzime qiraje prej 480.000 lekësh në vit.

14.5. Së pari, trupi gjykues vëren se është i drejtë pretendimi i subjektit për mospërfshirjen e shpenzimeve për pasuritë e deklaruar në deklaratën e parë [2003] si investime të atij viti. Në atë deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartamentin e banimit të përfituar nga privatizimi⁵⁸ në vlerën 0,014 milion lekë, si dhe automjetin tip “Audi”, në vlerën 200.000 lekë. Burim krijimi janë deklaruar të ardhurat personale të subjektit. Nga aktet në fashikull rezultojnë qartë që ky apartament është përfituar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj nga privatizimi i banesave shtetërore në vitin 1993. Për këtë arsye, vlera prej 14.000 lekësh e kryer në momentin e privatizimit nuk mund të përfshihet në analizën financiare të vitit 2003. Po ashtu, automjeti rezultojnë të jetë blerë në datën 17.01.2003⁵⁹, në vlerën 200.000 lekë. Për pasojë, në kushtet kur kontrata i përket *janarit* të vitit 2003, ky shpenzim duhet të vlerësohet kundrejt mjaftueshmërisë së kursimeve deri në fund të vitit 2002. Nga analiza e kryer në Kolegj për periudhën para vitit 2003, rezultojnë se subjekti ka pasur mundësi të krijojë kursime për të përballuar blerjen e automjetit në fjalë. Në përmbledhje, trupi gjykues arrin në përfundimin se të dyja këto pasuri janë përfituar me të ardhura dhe kursime të krijuara para deklaratimit të vitit 2003. Me korrektimin e këtyre vlerave, në ndryshim nga Komisioni, bilanci financiar i subjektit të rivlerësimit për vitin 2003 rezultojnë pozitiv.

14.6. Për sa i përket analizës financiare të viteve 2004-2005, subjekti i rivlerësimit konteston analizën e Komisionit për faktin që në shpenzimet e shkollimit të vajzës nuk janë përfshirë fondet e mbetura nga kredia prej 18.000 eurosh [ekuivalenti i 2.281.320 lekë] kundrejt pagesës së tarifës së shkollimit prej 8.320 GBP [ekuivalenti i 1.410.619 lekë]. Sipas subjektit, pasi është përdorur kjo shumë për pagesën e tarifës së shkollës, pjesa e mbetur prej 810.701 lekësh së bashku me të ardhurat familjare në vlerën 5.000 euro dhe të ardhurat e përfituara nga punësimi me kohë të pjesshme të vajzës së saj në vlerën 400 GBP, kanë shërbyer për të mbuluar shpenzimet e jetesës së vajzës në Londër. Subjekti pretendon se i vetmi shpenzim që ka bërë në këto vite ka qenë shkollimi i vajzës së saj.

14.7. Pa përsëritur sa shtjellohet gjerësisht më sipër për këtë zë shpenzimi, trupi gjykues vëren që subjekti ka deklaruar se kredia ka shërbyer për të mbuluar shpenzimet e shkollimit pasuniversitar të vajzës, pa specifikuar shifrën konkrete të përdorur nga kredia për këtë qëllim apo nëse është përdorur për tarifën e shkollimit, jetesën apo të dyja. Subjekti, po ashtu, *nuk* ka deklaruar gjendje *cash* të mbetur nga kredia në deklaratën periodike për vitin 2004. Në atë moment kohor, për gjendjen deri në 31 dhjetor të vitit 2004, në rubrikën e dedikuar ndryshimit të pasurive, subjekti ka deklaruar *të ardhura familjare cash 200.000 (dyqind mijë) lekë*, ndërsa në rubrikën e detyrimeve financiare ka deklaruar *kredi për pagesë master të vajzës 18.000 euro*. Në deklaratën e interesave periodikë të vitit në vijim [për vitin 2005], subjekti ka deklaruar *gjendje cash 400.000 (katërqind mijë) lekë realizuar nga kursimet familjare vjetore*. Nga sa më sipër, në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar gjendjen *cash* në asnjërën prej deklaratave periodike, prezumohet që e gjithë shuma është përdorur në vitin në të cilin kredia është marrë dhe përdorur. Për rrjedhojë, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mbi rëndësinë dhe vlerën provuese të deklaratave periodike, shtjelluar gjerësisht me jurisprudencën e Kolegjit për pretendimet për gjendje të likuiditeteve jashtë sistemit bankar që nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare nuk mund të përfshihet si e disponuar shuma prej 810 mijë lekësh në funksion të mbulimit të shpenzimeve të jetesës së vajzës së subjektit për vitet 2004-2005. Nga ana tjetër, fakti që ky pretendim ngrihet për herë të parë *vetëm* në një fazë të avancuar të hetimit, pas kalimit të barrës së provës, e bën atë jobindës dhe si përpjekje për të përmirësuar sa ka rezultuar nga analiza financiare për vitet me bilanc negativ.

⁵⁸ Referuar gjerësisht më sipër në kuadër të të ardhurave nga shitja e tij në vitin 2006.

⁵⁹ Referuar kontratës noteriale të shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.01.2003.

14.8. Siç është analizuar në detaj në paragrafin 12 dhe nënpjesët e tij, nga analiza e të ardhurave përkundër mbulimit të shpenzimeve të studimit të vajzës së subjektit, kryer në funksion të kontrollit të vendimit të Komisionit, rezulton se edhe nëse abstragohet nga faza e hetimit kur ky pretendim është parashtruar për herë të parë, nëse kredia është përdorur për shpenzimet e jetesës në Londër në vitin 2004 dhe për të mbuluar tarifën e studimeve pasuniversitare, vlera që do të mbetej nga 18.000 euro do të ishte 37.383 lekë, shumë e ndryshme nga 810.000 lekë, sikurse pretendon subjekti. Vlera e mbetur është e pamjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës në Londër në vitet në vijim, 2005-2006. Nëse hipotetikiht pranohet që shpenzimet e jetesës së vajzës në Londër në vitin 2004 janë mbuluar nga burime të tjera, dhe jo kredia, vlera e mbetur⁶⁰ do të duhet të kishte gjetur një pasqyrim në gjendjen e *cash-it*, minimalisht në fund të vitit 2004 e në vijim. Së fundmi, trupi gjykues sjell në vëmendje që pamundësia financiare qëndron edhe nëse hipotetikiht merret në konsideratë vlera e pretenduar e mbetur nga kredia, prej 810.000 lekësh. Nga përlllogaritja e tarifës së studimeve dhe sa referojnë burimet zyrtare të Britanisë së Madhe për shpenzimet e jetesës, cituar më sipër, kjo shumë është gjithsesi e pamjaftueshme për të mbuluar vlerën totale të shpenzimeve të jetesës në Londër, që rezultojnë minimalisht në ekuivalentin e 2.140.540 lekëve për vitet 2004-2006.

14.9. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që në të ardhurat e vitit 2005 të përfshihet pagesa 400 GBP nga punësimi me kohë të pjesshme, për disa muaj, i vajzës së saj në Londër. Gjatë hetimit administrativ, për vërtetimin e përfitimit të kësaj të ardhure, vajza e subjektit ka kërkuar dokumentacion nëpërmjet korrespondencës elektronike më datë 06.03.2019. Nga përgjigja, që mban të njëjtën datë, rezulton se kompania ka ofruar të vërë në dispozicion informacionin e kërkuar kundrejt një kërkesë të drejtpërdrejtë nga institucioni kërkuar [Komisioni]. Në fashikull nuk rezulton korrespondencë e mëtejshme për këtë aspekt.

14.10. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 e kanë përcaktuar qartë detyrimin e subjektit që të deklarojë saktësisht në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit gjithë të ardhurat dhe të paraqesë dokumentacion mbështetës. Në kushtet kur subjekti pretendon një të ardhur, ajo pikësëpari duhet të kishte gjetur pasqyrim në deklaratën periodike vjetore, deklaratën e pasurisë për rivlerësimin ose në të dyja. Ky pasqyrim nuk ka ndodhur. Ndonëse e ndërgegjegjshme për detyrimet e saj në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka paraqitur në një fazë të avancuar në proces një pretendim për një të ardhur, pa sjellë dokumentacion. Në kushtet kur detyrimi për të provuar të ardhurat e pretenduara ishte barrë e subjektit, ndërsa përgjigja e personit juridik përkatës kërkonte përfshirjen e Komisionit, në funksion të një qasjeje harmonike e objektive, ndërsa Komisioni nuk rezulton të ketë arsyetuar një qëndrim për këtë aspekt, trupi gjykues kreu edhe një analizë financiare të vitit 2005, duke i përfshirë këto të ardhura. Duke abstraguar nga fakti që trupi gjykues konstaton se *nuk* gjen zbatim pamundësia objektive e parashikuar nga neni 32, pika 2⁶¹e ligjit nr. 84/2016, rezulton se edhe nga përfshirja e të ardhurave të pretenduara, nën dritën e arsyetimit të mësipërm, bilanci negativ i vitit mbetet thuajse i pandryshuar.

14.11. Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare e Komisionit për vitin 2006 duhet të përlllogarisë të ardhura nga paga e vajzës në vlerën 562.032 lekë. Subjekti pretendon se vlera 224.813 lekë e pasqyruar në analizë bie ndesh me vërtetimet nga punëdhënësit “Albinvest” dhe

⁶⁰ Vlera e mbetur në këtë rast do të ishte rreth 558.000 lekë [2.028.347 – 1.470.619], përsëri më e ulët nga vlera e pretenduar nga subjekti prej 810.000 lekësh.

⁶¹ “[2.] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. Ky rregull zbatohet edhe në ato raste kur organi përgjegjës për lëshimin e dokumenteve justifikuese nuk përgjigjet brenda afatit ligjor.[...]”.

fondacioni “Mjaft”. Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlera e përlllogaritur nga Komisioni është e saktë, pasi përbën vlerën e konfirmuar nga dokumentacioni. Pretendimi i subjektit për të përlllogaritur të ardhura 2.5 herë më të larta sesa ato që rezultojnë nga dokumentacioni, për rrjedhojë është i pabazuar. Ky konkluzion bazohet në analizën që vijon.

a. Në deklaratën periodike për vitin 2006, subjekti ka deklaruar që paga vjetore e vajzës ishte 6.000 USD dhe “projekt njëvjeçar”.

b. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se vajza paguhej me një kontratë shërbimi nga shtatori 2006 deri në qershor 2007, me 600 USD në muaj.

c. Në përgjigjen e pyetësorit nr. 3, subjekti ka konfirmuar që vajza ka punuar gjithsej 10 muaj, nga të cilët, katër (4) në vitin 2006 dhe gjashtë (6) në vitin 2007, me pagë mujore 600 USD në muaj. Subjekti ka pretenduar edhe që detyrimet tatimore për këto pagesa janë përgjegjësi e institucionit – fondacioni “Mjaft” – në rastin konkret.

d. Në fashikull gjendet një vërtetim nga Misioni i Bankës Botërore në Shqipëri [datë 25.09.2019] që konfirmon pagesën mujore dhe detyrën e kryer nga vajza e subjektit për 10 muajt në fjalë, në total 6.000 USD. Nga ana tjetër, në fashikull nuk rezulton dokumentacion që provon punësimin apo pagesën nga “Alinvest”.

14.12. Nga analiza e akteve të mësipërme, rezulton e provuar pagesa në total për vitin 2006 prej 2.400 USD, për katër muajt e fundit të vitit, e konvertuar në lekë në vlerën e përlllogaritur nga Komisioni. Për këto arsye, pretendimi i subjektit, për të ardhura në ndonjë vlerë përtej sa është konfirmuar me dokumentacion, rezulton i pabazuar. Vërtetimi i Lëvizjes Mjaft [datë 24.09.2019] referon të ardhura nga paga për vajzën e subjektit për periudhën 2008-2010. Për rrjedhojë, ky i fundit është pa relevancë në këtë shkak ankimi.

14.13. Subjekti pretendon se Komisioni ka gabuar në llogaritjen e të ardhurave nga paga e bashkëshortit për vitin 2003 dhe 2004, duke i pasqyruar në vlerën 622.670 lekë dhe 791.050 lekë, ndërkohë që vërtetimi i Universitetit të Sporteve i referon ato përkatësisht në vlerën 634.573 lekë për vitin 2003 dhe 821.215 lekë për vitin 2004 [nr. {***}, datë 30.04.2020.] Trupi gjykues vëren se nga aktet në fashikull rezultojnë dy përgjigje nga Universiteti i Sporteve, me vlera që nuk përputhen mes tyre, ndonëse me diferenca relativisht të vogla. Konkretisht, në dosjen e përcjellë nga ILDKPKI-ja në Komision, gjendet një shkresë e datës 10.10.2016, e Rektorit të Universitetit të Sporteve. Në tabelën e të ardhurave bashkëlidhur, përcaktohet se të ardhurat për personin e lidhur/bashkëshortin, janë në vlerën 627.670 lekë për vitin 2003 dhe 791.050 lekë për vitin 2004. Në përgjigjen dërguar në procesin e hetimit administrativ, në prill 2020, i njëjti institucion referon vlerat e argumentuara nga subjekti i rivlerësimit, që janë më të larta me përkatësisht 6.903 lekë dhe 30.165 lekë. Komisioni ka përlllogaritur të ardhurat bazuar në shkresën e parë, atë të vitit 2016. Në kushtet kur nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2003 dhe ajo e kryer në Komision për vitin 2004, subjekti rezulton me balancë pozitive, korrigjimi i këtyre të ardhurave, edhe duke abstraguuar nga mospërputhjet e dukshme mes vlerave të referuara nga institucioni përgjegjës, nuk ka asnjë peshë në zgjidhjen e çështjes.

14.14. Subjekti pretendon se Komisioni në analizën financiare ka pasqyruar gabim vlerën e kredisë së marrë në “Raiffeisen Bank”, në vitin 2006. Referuar kontratës së kredisë bankare, datë 10.04.2006, shuma e marrë kredi është 500.000 lekë dhe jo 408.000 lekë, parashtron subjekti.

Nga aktet në fashikull rezulton se vlera prej 408.000 lekësh, të cilën Komisioni ka marrë në konsideratë, përfaqëson principalin e mbetur të papaguar të kredisë në datën 31.12.2006, sipas

konfirmimeve bankare⁶². Trupi gjykues vëren se nëse në vlerën e kredisë do të paraqitej vlera e plotë e disbursuar, një zë i veçantë në analizë do të duhet të pasqyronte *shpenzimet për pagesë këstesh kredie për principal*, ndërsa efekti në rezultatin financiar do të ishte i njëjtë. Duke pasqyruar drejtpërdrejt vlerën e mbetur të kredisë pas shlyerjes së pagesës, Komisioni ka pasqyruar saktë sasinë e të ardhurave hyrëse për vitin përkatës. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për llogaritjen e të gjithë shumës në analizën financiare konsiderohet i pakuptimtë.

14.15. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare të Komisionit, lidhur me shpenzimet e udhëtimit të vajzës së saj në vitin 2006, në vlerën prej 1.050 eurosh. Sipas subjektit, shpenzimet e udhëtimit janë kryer për arsye pune dhe shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga punëdhënësi i vajzës së saj. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti referon vërtetimin, datë 25.09.2019, nga përfaqësuesja e Misionit të Bankës Botërore në Shqipëri. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim i subjektit mbeti deklarativ. Subjekti nuk ka sjellë dokumentacion që të provojë që udhëtimet e kryera jashtë shtetit në vitin 2006, të cilat janë objekt ankimi, ishin në funksion të detyrës. Për rrjedhojë, përlllogaritja e kryer nga Komisioni është e bazuar. Ky konkluzion bazohet në analizën e akteve në vijim.

14.16. Sipas vërtetimit të sipërcituar, nënshkruar nga drejtuesja e misionit të Bankës Botërore për Shqipërinë, që mban datën 25.09.2019, konfirmohet punësimi i vajzës së subjektit në një projekt të financuar nga ky institucion dhe të implementuar nga Lëvizja Mjaft, për periudhën shtator 2006 – qershor 2007 [referuar edhe më sipër lidhur me të ardhurat e vitit 2006]. Në këtë dokument përcaktohet vetëm paga e përfituar. Nuk ka asnjë referencë për udhëtime të sponsorizuara nga Banka Botërore apo aktivitete të tjera që mund të shërbenin si indicie indirekte për shpenzime të kryera për shkak të detyrës. Për rrjedhojë, ky dokument nuk konsiderohet se ka vlerë provuese për këtë zë të analizës financiare.

14.17. Nga ana tjetër, vërtetimi i drejtuesit ekzekutiv të Lëvizjes Mjaft, që mban datën 27.01.2020, konfirmon punësimin e vajzës së subjektit pranë kësaj organizate joqeveritare për periudhën janar 2008 – dhjetor 2010, një periudhë kohore për të cilën analiza financiare në Komision ka rezultuar me balancë pozitive. Për rrjedhojë, ky akt nuk ka asnjë peshë në justifikimin e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2006.

14.18. Në përfundim dhe në përmbledhje të gjithë sa është arsyetuar në detaj më sipër, nga analiza financiare për periudhën e rivlerësimit, duke përfshirë edhe shpenzimet e investimet e kryera ndër vite, trupi gjykues i Kolegjit çmon që konfirmohet balanca negative e konstatuar nga Komisioni për vitet 2005 dhe 2006. Si rrjedhojë, për këto vite, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

15. Cash-i i deklaruar në deklaratën vetting, në shumën prej 10.000 eurosh

15.1. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme që të realizojë dhe disponojë likuiditetet *cash* në vlerën 10.000 euro, të deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kushtet kur nuk ka deklaruar kursime në deklaratat periodike vjetore për periudhën 2009 – 2016, kjo e fundit dorëzuar më 24 shkurt 2017, pas deklaratës *vetting*. Po ashtu, më herët, subjekti ka deklaruar *zerimin* e gjendjes së *cash*-it, në deklaratën periodike për vitin 2008. Komisioni ka vlerësuar se shpjegimet e subjektit janë jobindëse. Për këto arsye, si dhe duke mbajtur në vëmendje që edhe burimet e cituara, ndër vite, nga subjekti kanë rezultuar të paprovuara në kuptimin e burimit të ligjshëm, sipas

⁶² Me shkresën nr. {***} prot., datë 26.07.2019, Drejtoria e Përgjithshme e “Raiffeisen Bank” ka informuar Komisionin për kreditë e marra nga Dh. e Flutura Skënderi, duke referuar që kredia e marrë në datën 10.04.2006, në shumën 500.000 lekë është mbyllur në datën 23.09.2008.

parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklarime kontradiktore dhe të pasakta lidhur me zotërimin e gjendjes *cash*.

15.2. Në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj, subjekti pretendon se deklaratimet e saj në deklaratën *vetting* lidhur me zotërimin e gjendjes *cash* janë të sakta dhe ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të realizuar dhe disponuar këtë gjendje *cash*. Duke iu referuar shpjegimeve të dhëna prej saj⁶³ në rezultatet e hetimit, pas kalimit të barrës së provës, subjekti potencon se likuiditeti prej 10.000 eurosh, përbën kursime të periudhës 2012 – 2017, nga disa zëra të ardhurash: kryesisht nga aktiviteti i bashkëshortit jashtë orarit të punës, të deklaruara në vitet 2012-2016, të ardhurat e përfituara nga puna e vajzës, e ardhura e përfituruar nga një vendim i Agjencisë Kombëtare të Kthimit të Pronave marrë në 30 prill 2015. Sipas subjektit, shumatorja e këtyre të ardhurave ka gjeneruar shumën *cash* në fjalë.

15.3. Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash* jashtë sistemit bankar në deklaratat periodike vjetore të viteve në harkun kohor 2009-2016 dhe as shtesa të *cash*-it të cilin e ka deklaruar në vlerën zero (0) në deklaratën periodike vjetore për vitin 2008. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit që përpiqen të barazojnë të ardhurat e fituara gjatë secilit vit me konceptin e *kursimeve* të krijuara, shtuara apo pakësuara në secilin vit, janë të pabazuara në ligj. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në vijim.

15.4. Duke nisur nga deklarata periodike për vitin 2009 e deri në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [*vetting*], subjekti nuk ka deklaruar zotërim, shtim apo pakësim të kursimeve jashtë sistemit bankar. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar *gjendje cash në shumën 10.000 euro, me burime nga të ardhurat familjare*, ndërsa në deklaratën vjetore të pasurisë për vitin 2016, plotësuar një muaj pas deklaratës *vetting*, në shkurt 2017, subjekti sërish nuk ka deklaruar *cash*. Vetëm në deklaratën periodike vjetore për vitin 2017 (plotësuar në 2018), subjekti ka referuar *gjendje cash*, e cila është *pakësuar nga 10.000 euro në 8.500 euro (për shpenzime familjare)*.

15.5. Nën dritën e dispozitave të ligjit nr. 84/2016, për rëndësinë provuese që marrin deklaratat periodike vjetore në procesin e rivlerësimit, Kolegji ka krijuar tashmë një jurisprudencë të konsoliduar për kursimet e deklaruara jashtë sistemit bankar, në funksion të vlerësimit të pasurisë në procesin e rivlerësimit. Në këtë kontekst, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje së pari se nën dritën e ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore duhet të deklaronte, përpos çdo ndryshimi të gjendjes *cash* krahasuar me deklarimin periodik të mëparshëm:

“[...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”⁶⁴.

15.6. Formulari i deklarimit të pasurisë për vitin 2004, i plotësuar nga subjekti i rivlerësimit, në faqen 3, përshkruan në detaj sa është referuar në dispozitën e sipërcituar, duke specifikuar që kërkohet të deklarohet çdo ndryshim (shtesë dhe pakësim) i interesave pasurorë. Nga ana tjetër, koncepti i të ardhurave, edhe nga ana logjike, sikurse edhe në formular, është

⁶³ Në këto shpjegime, subjekti ka pretenduar në detaje të hollësishme edhe njëherë të ardhurat e përfituara, nga punësimi dytësor i bashkëshortit dhe nga punësimi i vajzës në OJQ “{***}” dhe një kontratë me Këshillin e Evropës, e datës 1 korrik 2016 që ka vijuar në vitin 2017. Së fundmi, subjekti ka deklaruar edhe një vlerë prej 350.000 lekësh të përfituruar si kompensim të një sipërfaqeje prej 100 m², pronësia mbi të cilën i është njohur në vitin 1994 nga AKKP-ja.

⁶⁴ Neni 4, pika 1 dhe gërma “d” e të njëjtës dispozitë.

shprehimisht e qartësisht i dallueshëm nga koncepti i kursimeve. Të ardhurat janë të dhënat mbi bazën e të cilave në deklaratimet periodike, sikurse edhe në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, kontrollohen kursimet. Nëse pranohet logjika e prezantuar nga subjekti për të prezumuar që kursimet përbëhen nga të ardhurat, ligji nr. 9049/2003, por edhe ai nr. 84/2016 do të mjaftoheshin me kontrollin e bazuar mbi të ardhurat.

15.7. Për këto arsye, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, që meqenëse në vitet përkatëse ka deklaruar të ardhura përpos atyre të pagës kryesore të saj dhe bashkëshortit, këto të ardhura duhet të prezumohen se janë kursyer *cash*, jashtë sistemit bankar, për rrjedhojë është i pabazuar dhe sfidon logjikën, sikurse është kontradiktë me strukturën dhe sa kërkon secila faqe e formularit. Së fundmi, kjo mënyrë leximi e deklaratave që kërkon subjekti vetëm pasi u njoh me rezultatet e hetimit, bie ndesh edhe me qasjen e treguar prej saj ndër vite, në deklaratat periodike vjetore, kur subjekti ka deklaruar *cash* të kursyer apo të pakësuar – siç është deklarata për vitin 2008 dhe për vitin 2018, ndër të tjera. Me fjalë të tjera, subjekti kërkon të pranohet një qasje që nuk përputhet me ligjin, por as edhe me mënyrën sesi ajo vetë ka deklaruar përpara dhe pas deklaratës së pasurisë për rivlerësimin [vetting].

15.8. Sikurse është arsyetuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit⁶⁵, trupi gjykues thekson se në kushtet kur gjendja e likuiditeteve *cash* dhe ndryshimet e saj janë për nga natyra deklarative, vërtetësia e mjaftueshmëria e krijimit të tyre në procesin e rivlerësimit mund të kontrollohet, duke analizuar në mënyrë rigorozë deklaratat periodike ndër vite të subjekteve të rivlerësimit, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie. Për rrjedhojë, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin për gjendjet *cash* të mbartura në vite, të padeklaruara në deklaratat periodike, e vendosin atë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, parashikuar në nenin 33, pika 5, germa “b”.

16. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti ka ngritur shkaqe ankimi që lidhen me konstatimin e Komisionit për gjendjen e saj në kushtet e konfliktit të interesit. Ky aspekt rezulton të jetë analizuar nga Komisioni, pasi ka konstatuar se subjekti nuk ka kërkuar dorëheqjen në dy trupa gjykues në dy konflikte gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqërinë {***} ShPK , në vitet 2014 dhe 2015 [përkatësisht vendimet nr. {***} dhe nr. {***}, të Gjykatës së Apelit Tiranë]. Në kushtet kur Komisioni ka konkluduar se subjekti ka arritur, gjithsesi, një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues konstaton që konkluzioni i Komisionit nuk rezulton të jetë shoqëruar me pasojë në marrjen e masës disiplinore të shkarkimit për subjektin e rivlerësimit. Për pasojë, ky shkak ankimi u vlerësua përtej fushës së kontrollit të vendimit të Komisionit nga Kolegji.
17. Në përmbledhje dhe për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklaratimit të pamjaftueshëm. Si rrjedhojë, vendimi nr. 279, datë 23.07.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

⁶⁵ Shih, ndër të tjerë, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit A. Nela [JR nr. 8/2019], paragrafi 43; vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit E. Sadiku [JR nr. 7/2019], paragrafi 32.5, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit F. Qato [JR nr. 29/2019], paragrafi 31, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit A. Belishta [JR nr. 1/2020], paragrafi 50, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit E. Islamaj [JR] nr. 11/2019], paragrafi 27, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit Xh. Zaganjori [JR nr. 19/2019], paragrafët 84-85, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit G. Osmani [JR] nr. 20/2019], paragrafi 59, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit F. Lushi [JR] nr. 20/2020], paragrafi 19.4, vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit A. Madani [JR nr. 12/2021], vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit D. Peka [JR nr. 27/2020], paragrafi 19.4.iii, 19.4.v.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 279, datë 23.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Flutura Skënderi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.04.2023.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi-kundër

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM NË PAKICË

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, kam votuar kundër vendimit të dhënë nga trupi gjykues, për çështjen me nr. 56/2020 (JR) që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Flutura Skënderi, kundër vendimit nr. 279, datë 23.07.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Kam votuar për ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, mbështetur në arsyetimin dhe konkluzionet si më poshtë.
2. Siç pasqyrohet gjerësisht në vendimin e shumicës, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar prej Komisionit për të tria kriteret e rivlerësimit dhe në përfundim të procesit është konkluduar se, ndonëse ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, duke konkluduar se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë kriter, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
3. Komisioni ka konkluduar në këtë mënyrë, pasi: ka kontrolluar deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat periodike; ka verifikuar burimet e krijimit të pasurisë të saj të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*; si dhe ka kontrolluar mundësinë financiare të saj dhe personit të lidhur për përballimin e shpenzime të jetesës në vite, përfshirë dhe me fokus tek ato të kryera për financimin e arsimimit të vajzës së saj jashtë vendit.
4. Siç pasqyrohet dhe në vendimin e shumicës, pasuria e subjektit e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, që i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të këtij procesi, përbëhet nga një apartament me sipërfaqe 107 m², ndodhur në Tiranë, një automjet i tipit “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 1995, blerë prej personit të lidhur në vitin 2006 dhe pasurinë likuiditet prej 10.000 eurosh të deklaruar si gjendje *cash* në banesë në deklaratën *vetting*. Nën kontrollin e burimeve të krijimit të këtyre pasurive, janë marrë në analizë në mënyrë të veçantë, për shkak të peshës së tyre, edhe shpenzimet e kryera për studimet e vajzës jashtë vendit. Problematikat e konstatuara prej Komisionit dhe më pas edhe shumicës së trupit gjykues i referohen deklarameve lidhur me mënyrën e krijimit të këtyre pasurive, si edhe me burimet e krijimit të tyre dhe përballimin e shpenzimeve.
5. Në një qasje kronologjike në trajtimin e këtyre problematikave, si edhe vendimi i shumicës, do të ndalem kryesisht në qëndrimet dhe argumentet e ndryshëm në raport me to, të cilat kanë diktuar edhe krijimin e bindjes për qëndrimin tim kundër këtij vendimi.
6. **Lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 107 m², të ndodhur në Tiranë**

6.1 Siç rezulton edhe nga vendimi i Komisionit, në funksion të verifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit objekt kontrolli ka qenë sipërfaqja prej 50 m², nga 107 m² që është i gjithë apartamenti, e dakordësuar për t'u blerë për një vlerë prej 40.000 eurosh. Kjo situatë lidhet me origjinën e krijimit të kësaj pasurie, sipas së cilës, sipërfaqja prej 57 m² është përfituar prej subjektit me anë të një kontrate sipërmarrje, për shkak të qenies trashëgimtare e ish-pronarëve të tokës mbi të cilën është ndërtuar objekti ku gjendet edhe apartamenti që zotërohet prej subjektit të rivlerësimit.

6.2 Duke ndarë përgjithësisht të njëjtat konstatime, lidhur me deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato periodike apo për gjatë hetimit administrativ me ato të shumicës dhe vlerësimin se subjekti ka kryer deklaram të pasakta lidhur me këtë pasuri, kryesisht me detyrimin e mbetur shoqërisë në vlerën prej 20.000 eurosh, në kundërshtim me

parashikimet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, kam ndarë qëndrim të ndryshëm për sa i përket analizës dhe peshës së tyre në vlerësimin e pasurisë së subjektit.

6.3 Në vlerësimin tim, pavarësisht deklarimeve të paqarta e të parentitura saktë në kohë për transaksionet që lidhen me financimin/blerjen e pasurisë apartament, subjekti i rivlerësimit ka dhënë në deklaratën *vetting* një shpjegim që i jep sens deklaramit prej saj të vlerës prej 20.000 eurosh si detyrim të mbetur ndaj shoqërisë “{***}” ShPK. Ajo ka shpjeguar se ky detyrim është deklaruar si i tillë për shkak të faktit se kësaj shoqërie nuk i është paguar kjo shumë, sipas marrëveshjes/kontratës së sipërmarrjes, lidhur mes subjektit dhe shoqërisë, në mënyrë që të plotësohej shuma prej 40.000 eurosh që ajo i detyrohej shoqërisë për blerjen/përfitimin e sipërfaqes prej 50 m² në apartamentin ku banon. Por ndërsa, ky detyrim i parashikuar si i tillë në kontratën e sipërmarrjes kishte mbetur formalisht i pashlyer, veprim që do të duhej të pasqyrohej në kontratën e shitblerjes së pasurisë, e cila nuk ishte lidhur akoma deri në momentin e përpilimit të deklaratës *vetting*, subjekti në marrëveshje me shoqërinë kishte investuar këtë shumë në apartament për përfundimin e tij, madje edhe më shumë se aq, në vitet 2008-2009.

6.4 Sipas deklarimeve të subjektit, në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ dhe fakteve që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në vitin 2008 ka marrë nga “Raiffeisen Bank” një kredi në vlerën prej 885.000 lekësh dhe më pas në vitin 2009 ka marrë nga “Alpha Bank” një kredi në vlerën prej 4.000.000 lekësh, të destinuara për përfundimin e punimeve të apartamentit dhe mobilimin e tij. Në kredinë e marrë në “Alpha Bank” dorëzanës rezulton të jetë administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, z. A. A., fakt që përforcon bindjen se kjo kredi ka shkuar për përfundimin e punimeve të apartamentit, detyrim i shoqërisë sipas kontratës së sipërmarrjes.

6.5 Pavarësisht se subjekti nuk ka kryer deklarime të sakta në DPV-të respektive për destinacionin e këtyre kredive, ato përkojnë ekzaktësisht në kohë me momentin kur subjekti ka përgatitur dhe nisur banimin në apartamentin e ri, në kushtet kur banesa e vjetër ku ajo banonte ishte shitur në vitin 2006 dhe ishte liruar prej saj në vitin 2008 dhe faktit që subjekti banonte me qira, sipas deklaramit të vendbanimit në DPV-në e vitit 2008. Përveç këtyre fakteve, nuk rezulton nga hetimi asnjë investim tjetër i subjektit në këto vite, asnjë shpenzim i rëndësishëm që mund të justifikonte përdorimin e këtyre fondeve. Për më tepër, vajza e saj i kishte përfunduar studimet në vitin 2006 dhe kishte filluar marrëdhëniet e punës po në këtë vit, rrethana që të krijojnë bindjen se likuiditeti i marrë kredi në vlerën prej 4.885.000 lekësh të jetë përdorur, siç subjekti shpjegon, për përfundimin e punimeve të apartamentit dhe bërjen e tij të banueshëm.

6.6 Subjekti, gjithashtu, ka paraqitur gjatë hetimit disa fatura të lëshuara nga persona fizikë të ndryshëm, që hedhin dritë për natyrën e punimeve në apartament me karakter ndërtime dhe të atyre që kanë shërbyer për mobilimin e tij, duke mbështetur këtë linjë shpjegimesh që subjekti ka dhënë.

6.7 Në vlerësimin tim, prezenca e administratorit të shoqërisë si dorëzanës, në kontratën e kredisë me “Alpha Bank”, në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, potencon destinacionin e marrjes së saj në mbështetje të punimeve që do të duhej të kryente shoqëria, të cilat do kryhen personalisht prej subjektit, nëpërmjet kredisë bankare. Roli i administratorit si dorëzanes i jep kuptim dhe besueshmëri shpjegimit se përdorimi i kredisë do të zëvendësonte detyrimin që subjekti i kishte shoqërisë prej 20.000 eurosh të pashlyer ende, dhe njëkohësisht dokumentonte në dijeninë e shoqërisë se subjekti po kryente në apartament shpenzime për punime që i takonin shoqërisë e për të cilat do të duhej të paguhej detyrimi i mbetur. Në kushtet, kur me vullnetin/pëlqimin madje edhe marrjen përsipër të garantimit të shlyerjes së kredisë,

administratori i shoqërisë kishte pranuar këtë situatë, logjikshëm, dhe e provuar edhe në kontekstin e një konflikti apo mohimi të këtij investimi, subjekti mundet t'i kundërdrejtojë shoqërisë mospagimin e detyrimit prej 20.000 eurosh, në momentin e kryerjes së veprimit final për kalimin e pronësisë.

6.8 Ndërkohë, krahas pasaktësive dhe mosqartësisë së deklarimeve lidhur me detyrimin e shoqërisë, kam vlerësuar të rëndësishëm kontrollin e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, konkretisht të sipërfaqes prej 50 m² të blerë nga shoqëria “{***}” ShPK. Mbi këtë analizë, Komisioni nuk ka arritur në asnjë konkluzion negativ, pra, nuk ka konkluduar në asnjë situatë se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme për të financuar krijimin e saj, qoftë pagimin e këstit prej 20.000 eurosh në vitin 2006, qoftë financimin me anë të kredive 885.000 dhe 4.000.000 lekë të marra në vitin 2008 dhe 2009, për përfundimin e apartamentit dhe mobilimin e tij. Konkluzioni i Komisionit, lidhur me këtë pasuri i pasqyruar në paragrafët 43 e 44 të vendimit, përcakton në vija të përgjithshme se deklaratimet e subjektit lidhur me të janë kontradiktore të pasakta dhe jo bindëse, duke konkluduar se ka bërë deklarime të pamjaftueshme.

6.9 Në drejtim të kontrollit të këtyre konkluzioneve të Komisionit, kam vlerësuar të rëndësishëm kontrollin e burimeve të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, edhe në funksion të përcaktimit të peshës që këto pasaktësi të bëra në vite në deklaratat periodike, por edhe pasaktësia në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me detyrimin ndaj shoqërisë prej 20.000 eurosh, do të kenë në vlerësimin e pasurisë në tërësi të subjektit të rivlerësimit. Në këtë kontekst, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paguar në datën 21.11.2006, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, shumën prej 20.000 eurosh, sipas mandatpagesës nr. 28 të po këtij viti, lëshuar prej shoqërisë dhe nënshkruar edhe prej subjektit. Diferenca e shpenzuar për apartamentin përbëhet nga përdorimi i dy kredive bankare të përmendura më lart, të marra prej subjektit në vitet 2008 dhe 2009.

6.10 Në drejtim të verifikimit të burimit të krijimit të shumës prej 20.000 eurosh të paguar në nëntor të vitit 2006, sipas mandatpagesës së cituar dhe të pranuar si të tillë edhe nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se janë përdorur të adhuruarat e përfituara prej këstit të dytë të shitjes së apartamentit në pronësi të saj dhe personit të lidhur, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.07.2006, shitur në vlerën totale prej 5.000.000 lekësh. Deklarimin rreth përdorimit të këtij burimi, subjekti e ka përmendur në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe sqaruar më tej me shpjegimet gjatë hetimit administrativ. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate shitje dhe deklaratës noteriale të nënshkruar mes subjektit e personit të lidhur dhe shtetasit B. E. në datën 04.03.2006, rezulton se e gjithë shuma prej 5.000.000 lekësh, që përfaqëson çmimin e shitjes së kësaj pasurie, është përfituar prej subjektit para datës 21.11.2006, në të cilën figuron e paguar shuma prej 20.000 eurosh, për të cilën subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e apartamentit. Në këtë kuptim, subjekti ka provuar se ka pasur burime të ligjshme të krijuara nga shitja e pasurisë në pronësi të saj, për të paguar shumën prej 20.000 eurosh në vitin 2006. Diferenca negative që i ka rezultuar Komisionit dhe Kolegjit, lidhur me analizën financiare të këtij viti, nuk afekton krijimin e kësaj pasurie, siç ka konkluduar shumica e trupit gjykues, pasi vetë Komisioni nuk e ka konsideruar si të tillë, por edhe sepse burimi i krijimit të kësaj shume, i specifikuar qartë në deklaratën e pasurisë *vetting*, është shuma e përfituar prej shitjes së pasurisë në pronësi, e cila provohet se është zotëruar prej subjektit para se të kryhej kjo pagesë. Diferenca negative e këtij viti, sipas analizës financiare që do të elaborohet më tej në këtë mendim, duhet t'i atashohet shpenzimeve të tjera të kryera prej subjektit dhe krijimit të gjendjes së *cash*-it të deklaruar prej saj, si të disponuar në banesë në fund të vitit 2006.

6.11 Në vijim, sipas arsyetimit të bërë më lart, nga analizimi harmonik dhe integruar i deklarimeve të subjektit dhe të dhënave që kanë rezultuar prej dokumentacionit të administruar

gjatë hetimit administrativ, kam arritur në përfundimin se investimi i mbetur për krijimin e kësaj pasurie në vlerë të deklaruar prej 20.000 eurosh përfaqësohet në fakt nga investimi që subjekti ka kryer në këtë pasuri, në vitet 2008-2009, nëpërmjet përdorimit të kredive bankare të marra në këto vite, në total në shumën prej 4.885.000 lekësh. Përveç këtyre shumave, të cilat janë deklaruar se janë shpenzuar për përfundimin e punimeve të apartamentit, siç duket dhe nga përmbajtja e faturave të paraqitura prej subjektit, duket se subjekti ka përdorur në vitin 2008 edhe të gjithë gjendjen e *cash*-it të deklaruar si të akumuluar në vitin 2006, në vlerën prej 4.200.000 lekësh. Ndonëse nga analiza financiare e vitit 2006, duket se subjekti nuk kishte mundësi të krijonte të gjithë këtë vlerë me burime të ligjshme, për shkak të një balance negative në fund të vitit prej përafërsisht 580.000 lekësh, sërish diferenca e mbetur dhe që duhet konsideruar si e krijuar me burime të ligjshme është një shumë e konsiderueshme likuiditetesh që është konsumuar dhe zeruar në këtë vit, që, gjithashtu, përkon me kryerjen e punimeve dhe investimeve në këtë pasuri, e cila u bë e gatshme për banim në vitin 2009, siç rezultoi edhe nga deklarimi i subjektit në DPV-në 2009.

6.12 Në këto kushte, rezultoi se subjekti ka shpenzuar rreth 4.885.000 lekë dhe pasur në dispozicion përreth 3.600.000 lekë të tjera në *cash* të shpenzuara, pikërisht në të njëjtën periudhë, për të realizuar një grup punimesh që llogariteshin në vlerën prej 20.000 eurosh, sipas kontratës së sipërmarrjes. Duket qartë se shumata e krijuara me burime të ligjshme e të shpenzuara prej subjektit në vitet 2008-2009, për rreth 4.850.000 lekë + 3.600.000 lekë, superojnë dukshëm vlerën prej 20.000 eurosh që subjekti duhej t'i paguante shoqërisë “{***}” ShPK, nëse do ishte ajo që do të përfundonte punimet, sipas kontratës së sipërmarrjes. Kjo shumë është, gjithashtu, në mënyrë të arsyeshme e mjaftueshme edhe për të mobiluar një apartament me sipërfaqe 107 m², në vitin 2009.

6.13 Në këto rrethana, kam vlerësuar se pasaktësia e deklarimit që lidhet me detyrimin e deklaruar për shoqërinë “{***}” ShPK, në deklaratën *vetting* prej 20.000 eurosh, si edhe pasaktësitë në deklaratimet periodike të subjektit, ndonëse ekzistojnë dhe vështirësojnë kontrollin e krijimit të kësaj pasurie, në kushtet kur nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e saj, duhet të kenë një peshë relativizuese në vlerësimin e pasurisë, duke sugjeruar arsyeshëm zbatimin e parimeve që shoqërojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 6 dhe nenit 52, pika 1 të ligjit nr. 84/2016.

7. Gjendja e *cash*-it prej 10.000 eurosh deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*

7.1 Çështja tjetër për të cilën Komisioni dhe shumica e trupit gjykues kanë marrë një qëndrim penalizues, lidhet me gjendjen *cash* prej 10.000 eurosh të deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*. Komisioni në paragrafin 87 të vendimit ka konkluduar se *në kushtet kur subjekti nuk ka bërë deklarime për gjendje të kursimeve në cash në vitet 2009-2016, konsiderohet se ka bërë deklarime të pasakta e kontradiktore lidhur me këtë pasuri, por edhe se nuk ka pasur burime të ligjshme ta krijojë atë, në periudhën 01.01.2017 - 26.11.2017*. Të njëjtin qëndrim ka konfirmuar edhe shumica e trupit gjykues, qëndrim me të cilin nuk jam dakord për arsyt e analizuara më poshtë.

7.2 Subjekti ka deklaruar këtë gjendje likuiditetesh në *cash* në deklaratën e pasurisë *vetting* prej 10.000 eurosh, por nuk e ka deklaruar atë në DPV-në e vitit 2016, në të cilën prezumohet se do të deklarohet gjendja e likuiditeteve në datën 31.12.2016, por ka deklaruar në DPV-në e vitit 2017 se ka pakësuar gjendjen *cash* prej 10.000 eurosh në shumën prej 8.500 eurosh.

7.3 Në vlerësim të këtyre deklaratave, kam konsideruar se mosdeklarimi i gjendjes së *cash*-it në DPV-në e viti 2016 është një pasaktësi në këtë deklaram periodik, i cili shpjegohet me faktin se subjekti sapo e kishte deklaruar këtë gjendje, vetëm dy muaj më parë, në deklaratën e pasurisë *vetting*. Deklarimi i pakësimit të saj në vitin pasardhës 2017, me 1.500 euro, në

vlerësimin tim, tregon për mungesën e ndërgjegjësimit edhe për pasaktësinë që konstatohet në DPV-në e vitit 2016, përndryshe subjekti mund të përpilonte një deklaram shterues në drejtim të shërimit të kësaj pasaktësie. Mënyra e deklarimit vetëm duke treguar pakësimin e shumë presupozon se në perceptimin e subjektit ekzistenca e shumë ishte e njohur për organet për shkak të deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ishte e nevojshme vetëm të deklarohet gjendja e saj në fund të vitit 2017, e reduktuar në 8.500 euro. Në këtë kuptim, kjo pasaktësi në DPV-në e vitit 2016 nuk mund të shërbejë si një rrethanë që duhet të penalizojë subjektin e rivlerësimit.

7.4 Në këtë rast, ndryshe nga shumica mendoj se fuqia provuese e DPV-së të vitit 2016, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ç' relativizohet, duke qenë se kjo deklaratë është përpiluar pas nënshkrimit të deklaratës *vetting*. Në këtë kuptim, ajo që ligjvënësi ka dashur të potencojë, për efekt të provueshmërisë së deklarimeve të deklaratës *vetting*, nuk mund të jetë njësoj thelbësisht me peshë për sa i përket deklaratës së vitit 2016, e cila në çdo rast është plotësuar pas deklaratës *vetting*, për pasojë çdo informacion që vjen në të nuk vjen rastësisht apo në mënyrë genuine, siç ligji ka sugjeruar se vijnë deklarimet në deklaratat e mëparshme, por vjen në përputhje dhe në mbështetje të atyre që janë deklaruar në deklaratën *vetting*. Për pasojë, mungesa e pasqyrimin të kësaj gjendje *cash* në DPV-në e vitit 2016, ndërsa ajo është deklaruar në *vetting*, nuk mund të ketë të njëjtën peshë si mungesa e deklarimeve për këtë gjende në deklaratat e mëparshme, pa ditur peshën dhe vlerën provuese që një ligj i mëvonshëm do t'u jepte atyre. Për këto shkaqe, kam vlerësuar se kjo pasaktësi nuk mund të marrë peshën që kanë deklarimet për gjendjen e *cash*-it në deklaratat e mëparshme, për më tepër se fakti që në deklaratën e vitit 2017 nëpërmjet një deklarimi të tërthortë dhe jo dedikuar shërimit të kësaj pasaktësie, provon në fakt, pikërisht një deklaram të pasaktë dhe jo domethënës në përcaktimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

7.5 Ajo që merr peshë në vlerësimin e kësaj situatë, sipas mendimit tim, është kontrolli i burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj shumë deri në datën 26.01.2017, në të cilën ajo deklarohet se ekziston. Në drejtim të kontrollit të burimeve të krijimit të saj, nga analiza e deklaratave periodike të pasurisë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka zëruar të gjithë gjendjen e likuiditeteve në *cash*, në fund të vitit 2008, ashtu siç ka konstatuar Komisioni dhe shumica. Por në ndryshim nga konstatimet e mëtejshme të tyre, rezulton se në deklaratën e pasurisë së vitit 2015, në rubrikën e ndryshimeve në pasuri, subjekti ka deklaruar *shtesë në vlerën e lekëve që rrjedhin nga vendimi nr. {***}, datë 30.04.2015, i AKKP-së, me të cilin është kompensuar në të holla për 100 m², për një vlerë që është sa 1/4 e 1/5 të shumë prej 5.712.600 lekësh, e barabartë me 350.000 lekë. Subjekti ka pretenduar se kursimet e krijuara përgjatë viteve 2012-2017, në të cilën është përfshirë edhe kjo shumë, kanë përfaqësuar shumë prej 10.000 eurosh të deklaruar për saj si gjendje *cash*.*

7.6 Ndërsa jam dakord me qëndrimin e shumicës për sa i takon mosnjohjes së kursimeve të padeklaruara në vite, kam vlerësuar se duhej të konsiderohej në përlllogaritjen e kësaj gjendje *cash*, shuma e deklaruar si shtesë në vitin 2015 e përshkruar më lart, si edhe të verifikohej mundësia financiare për të krijuar kurse vetëm në vitin 2016, pasi, sipas arsytimit të parashtruar më lart, mungesa e deklarimit të saj në DPV-në 2016, pas deklaratës *vetting*, është një pasaktësi që duhet të vlerësohet në zbatim të parimit të objektivitetit. Sipas analizës financiare të kryer në Komision dhe të përcjellë subjektit të rivlerësimit me rezultatet e hetimit paraprak për vitin 2016 rezulton një balancë pozitive prej gati 2.692.363 lekësh. Kjo diferencë pozitive lehtësisht mund të justifikojë krijimin e një kurse prej gati 1.000.000 lekësh, të cilit po t'i shtohet edhe vlera e deklaruar si shtesë në vitin 2015 prej 350.000 lekësh krijon me burime të ligjshme shumë prej 10.000 eurosh të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*. Situata e financiare e familjes së subjektit vetëm për këtë vit krijon lehtësisht mundësinë për

krijimin e kësaj gjendje *cash*. Për pasojë, e kam gjetur të padrejtë konkluzionin e Komisionit, por edhe shumicës së trupit gjykues, lidhur me gjendjen e likuiditeteve në *cash*.

8. Analiza financiare për vitet 2005 dhe 2006

8.1 Çështja tjetër në të cilën kam ndarë një qëndrim të ndryshëm nga shumica lidhet me analizën financiare të viteve 2005 dhe 2006, e cila ka rezultuar me një balancë negative, sipas Komisionit dhe shumicës.

8.2 Komisioni në paragrafin 98 të vendimit ka konkluduar se subjekti dhe familja e saj gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, që rezulton nga analiza financiare e këtyre dy viteve, në total për një vlerë prej 1.800.083 lekësh.

8.3 Pa përsëritur dhe analizuar të gjithë treguesit që janë marrë në analizë nga Komisioni dhe shumica dhe që kanë diktuar këtë rezultat negativ, me të cilat jam dakord, po analizoj në vijim elementët, të cilët, në vlerësimin tim, duhej të trajtoheshin në një këndvështrim të ndryshëm, sipas leximit dhe çmimit të të dhënave që vijnë nga hetimi dhe që ndikojnë rezultatin negativ të vitit 2005.

8.4 Duke u dakordësuar me qëndrimin e Komisionit dhe shumicës se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion përfitimin e shumës prej 1.800.000 lekësh nga shtetasi B. E. që në vitin 2005, kam vlerësuar të drejtë kryerjen e analizës financiare të këtij viti pa konsideruar si të ardhur këtë shumë. Për shkak të kësaj situatë, analiza financiare e Komisionit e kontrolluar në Kolegj, mbështetur në pretendimet e konsideruara si të bazuara të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar me një balancë negative prej 1.436.009 lekësh. Kjo analizë në Komision, ashtu edhe në Kolegj, është kryer duke konsideruar se e gjithë kredia prej 18.000 eurosh e marrë prej subjektit në “Alpha Bank”, në vitin 2004, për të mbuluar shpenzimet e studimeve *master* të vajzës së saj, që zgjatën në periudhën 2004-2005 dhe janar 2006, është përdorur gjatë vitit 2004. Subjekti ka pretenduar se kredia është përdorur një pjesë në vitin 2004, për të mbuluar taksën e shkollës dhe diferenca në vitin 2005.

8.5 Nga leximi i DPV-së të vitit 2004, rezulton se subjekti ka deklaruar *kredi për pagesë të masterit të vajzës*, në vlerën prej 18.000 eurosh. Duke e konsideruar këtë vlerë si të hyrë në vitin 2004, por pa mbartur prej saj asnjë shumë në vitin 2005, Komisionit i ka rezultuar, sipas analizës financiare të përcjellë subjektit me rezultatet e hetimit, se ka pasur në vitin 2004 një tepriçë pozitive prej 738.551 lekësh. Në këtë vit, Komisioni ka llogaritur krahas shpenzimeve të tjera, tarifë shkollimi për *master* të vajzës në Londër vlerën prej 1.470.619 lekësh dhe shpenzime jetese në Londër për vitin 2004, vlerën prej 520.345 lekësh. Sipas kësaj logjike, subjekti ka konsumuar përreth 2.000.000 lekë për shkollimin e vajzës në studimet *master* në vitin 2004 dhe nuk ka përdorur asnjë të ardhur vjetore të familjes për ta mbështetur atë, ndërsa kishte të ardhura të cilat mund të shkonin në këtë drejtim.

8.6 Duke e gjetur të paarsyeshme dhe të ngurtë këtë analizë, kam vlerësuar se administrimi i shumës së kredisë, në funksion të përballimit të shpenzimeve të shkollimit të vajzës, duhet të përcaktohet sipas deklarimeve të subjektit, për sa kohë që destinacioni i saj ka qenë i mirëpërcaktuar në dokumentacionin bankar dhe në DPV-në e vitit 2004. Fakti i mosdeklarimit të gjendjes *cash* të mbetur nga kredia në fund të vitit 2004 e të mbartur për të përballuar shpenzimet, po për të njëjtin qëllim në vitin 2005, kam vlerësuar se nuk duhet të trajtohet si tregues i faktit se e gjithë kredia është përdorur vetëm për shpenzimet e vitit 2004, ndërsa të ardhurat familjare të këtij viti, pavarësisht se lejonin vënien në shërbim të këtyre shpenzimeve, nuk janë konsideruar si të tilla. Rregulli i ndjekur prej institucioneve të rivlerësimit lidhur me moskonsiderimin e shumave *cash* si të mbartura nga viti në viti, nëse nuk janë deklaruar në DPV-të respektive, nuk duhet të zërë vend në këtë rast, në të cilin kontrollohet përdorimi i një

shume të marrë kredi dhe jo një *cash* të krijuar si kursim prej të ardhurave të vitit. Për më tepër, shuma e marrë është destinuar për përballimin e shpenzimeve të studimeve *master* dhe mungesa e detajimit të shpenzimit të saj në DPV-të përkatëse, duhet vlerësuar në kontekstin e një administrimi familjar të të ardhurave në shërbim të shkollimit të fëmijës, pa pasur në fokus detajimin e kryerjes së këtyre shpenzimeve nëpër deklaratat periodike të pasurisë. E gjithë kjo situatë lidhet detyrimisht edhe me kulturën e deklarimit në kohën që merret në analizë, por edhe me tipologjinë e subjektit të rivlerësimit, e cila paraqet problematikë me deklaratimet periodike në vite, në disa drejtime, edhe në situata në të cilat e vërteta e dokumentuar është më e favorshme për të se sa vetë deklarimi i saj.

8.7 Duke vlerësuar në këtë kontekst këtë problematikë, kam konkluduar se duhej pranuar shpjegimi që subjekti ka dhënë lidhur me mënyrën e përdorimit të kredisë studimore të ndarë në dy vite 2004-2005, shpjegim i cili do të ulte balancën negative të vitit 2005 me të paktën përreth 557.000 lekë⁶⁶, për pasojë në këtë nivel edhe balancën totale negative prej 1.800.069 lekësh për dy vitet 2005 dhe 2006.

8.8 Për sa më sipër, gjendur në këto situata dhe duke mbajtur thelbësisht në vëmendje specifikat e rastit, që i dedikohen kryesisht: (i) deklarimeve të pasakta në funksion të blerjes së një pasurie prej 50 m² në vlerën prej 40.000 eurosh, për të cilën janë përdorur si burime të ardhura nga shitja e një apartamenti në pronësi në vlerën prej 5.000.000 lekësh dhe të ardhura nga kreditë bankare në vlerën prej 4.885.000 lekësh; (ii) përballimit të shpenzimeve për shkollimin e vajzës, për të cilën është përdorur, ndër të tjera, edhe një kredi bankare në vlerën prej 18.000 eurosh; (iii) të gjendjes së *cash*-it në vlerën prej 10.000 eurosh të justifikuar me burime të ligjshme; (iv) blerjes së një automjeti në vitin 2006, që ka shkaktuar një balancë negative prej përreth 1.300.000 lekësh; si dhe (v) mosnjohjen si të ardhura të ligjshme të të ardhurave të krijuara prej bashkëshortit të subjektit prej një aktiviteti dytësor të zhvilluar për shumë vite, i cili është pranuar se ka ekzistuar edhe prej Komisionit, kam arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk duhej të penalizohej me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Të gjitha këto problematika të vendosura në kontekstin e një subjekti me shumë vite punë e eksperiencë në sistemin e drejtësisë, e që më së shumti janë produkt i deklarimeve të pasakta e të pakujdesshme, por nuk dominohen nga mungesa e burimeve të ligjshme, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, duhej të kishin çuar trupin gjykues në përfundimin se niveli i besueshëm i vlerësimit të pasurisë ishte arritur e, për pasojë, vendimi i Komisionit për shkarkimin e saj duhej ndryshuar e subjekti të konfirmohej në detyrë.

GJYQTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

⁶⁶ Duke konsideruar se kredia prej 18.000 eurosh e konvertuar në 2.028.347 lekë, sipas kursit të kohës, është përdorur pjesërisht për pagimin e tarifës së shkollimit në vitin 2004 në vlerën prej 1.470.619 lekësh dhe diferenca e mbetur për t'u përdorur për mbulimin e shpenzimeve të masterit në vitin 2005, mund të jetë në vlerën 557.728 lekë.